

SHOQËRIA E MËSHIRËS

Rinia e devotshme

12 Pyetje - Përgjigje

Osman Nuri TOPBASH





Shkodër, 2021

TITULLI ORIGINJAL
RAHMET TOPLUMU
HAYIRLI GENÇLİK

PËRKTHEU
Fatmir Sulaj

REDAKTOI
Ilir Hoxha

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi “2 Prilli”, Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

SHOQËRIA E MËSHIRËS

Rinia e devotshme

12 PYETJE – PËRGJIGJE

Osman Nuri TOPBASH

PARATHËNIE

Falënderimet dhe laudërimet e pafundme qofshin për Allahun e Lartësuar i Cili na ka krijuar nga asgjëja dhe na ka bërë njerëz ndërmjet krijesave, besimtarë ndërmjet njerëzve, umet i Muhamedit ndërmjet besimtarëve dhe na ka nderuar duke na zbritur Kuranin Fisnik!

Salatet dhe selamet e pafundme qofshin për Hazreti Muhamed Mustafanë, i cili është udhërrëfyesi ynë në këtë botë dhe ndërmjetësuesi ynë në botën e përtejme, për familjen e tij dhe për shokët e tij!

Me datën 6 prill 2019 kemi bërë në Ankara me vëllezërit e motrat tona të reja e të nderuara një bashkëbisedim të titulluar **“Shoqëria e Mëshirës – Rinia e Devotshme”**.

Vëllezërit dhe motrat tona të reja më parë patën dërguar me qindra pyetje për t’u dhënë përgjigje nga ana jonë në këtë program, por ngaqë nuk ishte e



mundur për t'iu përgjigjur të gjitha këtyre pyetjeve për një-dy orë, u përpoqëm që t'u jepnim përgjigje disa pyetjeve të zgjedhura prej këtyre.

Përveç të tjerash, disa çështjeve të cilat nuk patëm mundësinë t'i shpjegonim përgjatë bashkëbisedimit për shkak të kohës së kufizuar, u kemi shtuar edhe përgjigjet e disa pyetjeve dhe deshëm që t'jua paraqisnim juve lexues të nderuar në formën e një libri me shpresën se do të jetë më shumë përfitues.

Shpresoj që ky libër modest që keni në duart tuaja të sjellë dobi dhe lutem që si vëllezërit të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për përgatitjen e këtij programi, ata që na kanë nderuar duke frekuentuar në bashkëbisedimin tonë apo edhe ju lexues të nderuar që na shoqëroni shpirtërisht nëpërmjet këtij libri, të jeni të lumtur në të dyja botët.

Osman Nuri TOPBASH

Qershor 2019

Yskydar



Njeriu i Mëshirës

Zemra e besimtarit që e ndjen thellë vuajtjen e vuajtësit, pothuajse vlon si një kazan i madh. Bota e tij shpirtërore është një vend mëshire që strehon brenda të gjitha krijesat. Siç është e pamundur për diellin që të mos ngrohë, po ashtu është e pamundur edhe për shpirtrat sublimë që të mos ndjejnë keqardhje ndaj njerëzve, të mos u shërbejnë atyre dhe të rrinë indiferentë ndaj vuajtjeve e halleve të tyre. Besimtarët e përsosur që kanë fituar këndvështrimin ndaj krijesave nga shikimi plot mëshirë i Krijuesit, bëhen shpirtbutë e të brishtë si lulet dhe bujarë e dorëdhënë si pemët me fruta, duke u thelluar në urtësinë e luleve që çelin, zogjve që cicërojnë dhe pemëve që japin fruta.

Pyetja 1.

Ju thoni: “Çdo civilizim ndërton tipin e njeriut të vet.” Si e përkufizoni tipin e njeriut që ndërton/ edukon civilizimi Islam i cili është civilizimi ynë? Çfarë cilësish duhet të posedojë tipi i këtij njeriu?

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik flet rreth Qenies së Tij sublime më së shumti me emrat **Rrahman** dhe **Rrahim**. Ai na njofton se **Resulullahu**, të cilin e ka dërguar si “**mëshirë për botët**”, është rrauf dhe rrahim, domethënë shumë i butë dhe shumë i mëshirshëm.

I Nderuari ynë ﷺ thotë:

الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

“Njeriu është me atë që e do.” (Buhari, Edeb, 96)

Bazuar në këto që thamë më sipër, edhe ne si robër të Allahut i Cili është **Rrahman** dhe **Rrahim** dhe umet i Pejgamberit tonë të nderuar i cili është **Rrauf** dhe **Rrahim**, duhet të jemi “Njerëz të Mëshirshëm”.

Mirë, por çfarë cilësish duhet të ketë “Njeriu i Mëshirshëm”? Këto dëshiroj t’i përmbledh shkurtimisht:

Në ajetin e fundit të sures Fet’h flitet për “ata që gjendeshin pranë të Dërguarit të Allahut” si një shembull i njeriut të mëshirshëm. Ndërsa cilësitë e tyre dalluese janë:



✓ E mbrojnë besimin, janë të ashpër kundrejt jobesimtarëve, nuk bëjnë lëshime në Islam, e zbatojnë Islamin dhe përpiqen t'ua transmetojnë atë edhe të tjerëve. Të zbatuarit e Islamit dhe përpjekja për t'ua transmetuar atë edhe të tjerëve janë një mirësi dhe nder i madh nga Allahu.

✓ Rregulli i dytë: Përsëri vijnë te mëshira. Pra, butësia dhe mëshira. Besimtarët që gjendeshin pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishin shumë të mëshirshëm kundrejt njëri-tjetrit.

✓ Në lidhje me afërsinë e atyre njerëzve të mëshirës ndaj Allahut Teala, thuhet: **“Ti i sheh ata duke bërë ruku dhe duke bërë sexhde.”** Nga zemra e besimtarit shpërthen një frymëzim, përshtirshmëri dhe mëshirë e veçantë për shkak të kënaqësisë shpirtërore që shijon në ruku dhe sexhde.

✓ Ata, njerëzit e mëshirës, duke e perceptuar dhe duke qenë të vetëdijshëm se gjenden në mëtejpin e sprovës hyjnore, nuk kërkojnë interesat e përkohshëm në këtë botë, por kërkojnë virtytet që kanë dobi të përhershme dhe kënaqësinë e Allahut (xh.xh.).

Këto janë cilësitë që përmenden në Teurat. Për sa u përket atyre që përmenden në Ungjill, Allahu i Lartësuar këtë çështje e shpjegon me një shembull. Në tokë hidhet një farë. Ajo farë shndërro-



het në filiz. Pastaj i trashet trangu. Në këtë mënyrë i zemëron qafirët edhe zhvillimi i Islamit. Zhvillimi i njerëzve të mëshirës, siç po ndodh edhe sot, i zemëron jobesimtarët. Allahu i Madhëruar u premton falje dhe shpërblim të madh këtyre njerëzve të mëshirës që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.



Hadithi fisnik që i gëzonte më së shumti sahabët e nderuar, ishte:

“Njeriu është me atë që do.” (Muslim, Birr, 163.)

Shenja e dashurisë është bindja. Sahabët e nderuar ishin të mahnitur ndaj të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam. Kur e shikonin atë, shihnin një monument njerëzor. Ata i ndoqën gjithmonë gjurmët e të Nderuarit tonë, në mënyrë që ta përjetonin edhe në botën e përtejme unitetin të cilin patën fatin ta përjetonin me të në këtë botë. Atë e ndoqën me aq shumë përpikëri, sa që uleshin nën pemën ku kishte pushuar Pejgamberi (a.s.), pinin ujë ku kishte pirë ai dhe falnin namaz në vendin ku edhe ai ishte falur.

Për shembull **Abdullah ibn Omeri** ﷺ, përgjatë një haxhi u ul për një kohë të caktuar mbi në gurë të madh buzë Xhebelu'rr-Rrahme. Kur u pyet për shkakun e kësaj, u përgjigj duke u shprehur:

“I Dërguari i Allahut ﷺ, pati qenë ulur për një



kohë të caktuar mbi këtë gur të madh pas Haxhit të Lamtumirës.”

Gjithashtu, një herë tjetër, kur po udhëtonte me karvan, e ndaloi karvanin në një vend, shkoi te një pemë që gjendej mbi një kodër dhe u kthye. Atyre që e pyetën për arsyen e këtij veprimi, u tha:

“Një ditë, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, po kalonte këtej, shkoi (e pushoi pak) nën atë pemë dhe u kthye...”

Ja pra, në këtë nivel ishte ndjeshmëria e sahabëve të nderuar, të cilët ishin “njerëz të mëshirës”, për të ndjekur Resulullahun (s.a.s.).



Cilat janë cilësitë e tjera dalluese, të cilat janë reflektim nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.), të njeriut të mëshirës?

✿ **Njeriu i mëshirës është i butë dhe i mëshirshëm.**

Ai i shikon të gjitha krijesat me dhembshuri. Mëshirë ndaj maces, qenit, zogut që fluturon, pemës dhe ndaj çdo gjëje që ka krijuar Allahu (xh.xh.)...

✿ **Njeriu i mëshirës jep nga pasuria e tij si infak.**



لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë (përsosmërinë në besim, ibadet, moral dhe vepra), derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni (në rrugë të Allahut)...” (Al Imran, 92)

Miqësia me Allahun e Lartësuar mund të formohet vetëm me një vetëdije të tillë infaku.

Zekati në fakt është i detyrueshëm dhe masa e tij është e caktuar... Ndërsa infaku është i hapur dhe nuk ka fund... Shfaqjen e pikës kulmore të kësaj e shohim te i **Dërguari i Allahut** ﷺ.

Pejgamberi ynë i Nderuar ﷺ mendonte për umetin më shumë sesa për veten. Asnjëherë nuk mendonte që të hante vetë ose familja e tij, përpara se të hanin sahabët. Çfarëdo që kishte në dorë, ua jepte nevojtarëve. Për ditë të tëra në shtëpinë e tij nuk ndizej oxhaku dhe nuk gjendej bukë.

Nëna jonë, Aishja (r.anha), shprehet:

“Pjesëtarët e familjes së të Dërguarit të Allahut ﷺ, nuk e kanë ngopur barkun me bukë gruri tri ditë njëra pas tjetrës që kur (Resulullahu) ka shkuar në Medinë e deri kur ka ndërruar jetë.”
(Muslim, Zuhd, 20.)

Ndërkohë në shtëpitë e bekuara të të Nderuarit tonë vinin dhurata dhe plaçka të luftës. Po të dëshi-



ronte mund të bënte jetën më luksoze në Medine, por i Dërguari i Allahut ﷺ, këtë plaçkë lufte dhe këto dhurata ua jepte menjëherë As'habu's-Suffe dhe nevojtarëve. Prej tyre ndante vetëm një pjesë të mjaftueshme për shtëpinë e vet. Madje edhe atë që ndante për shtëpinë e tij, kishte raste që ia jepte ndonjë të varfri tjetër që shkonte më vonë, sepse ai nuk gjente prehje ndërkohë që umeti ishte i uritur dhe në nevojë. Përhapja e kësaj mëshire i falte atij një kënaqësi të papërshtueshme. Ai merrte aq shumë kënaqësi nga shpërndarja (e gjërave që kishte), sa që pothuajse e harronte urinë e vet dhe ngopej me shijen që i jepte infaku. Shija madhështore që të fal përshtueshmëria!..

Njeriu nga aspekti material, për shembull nëse ha dy-tri pjata me ushqim në iftar, ngopet. Tashmë nuk mund ta hajë ushqimin e pjatës së katërt. Por përshtueshmëria nuk është ashtu. Sa më shumë që të jepte i Dërguari i Allahut ﷺ, aq më shumë gjente prehje. Sa më shumë që të jepte, aq më shumë i shtohet dëshira për të bërë infak.

✽ Njeriu i mëshirës është sakrifikues

Allahu Teala thotë:

ثُمَّ لَسْأَلَنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote që ua kemi dhënë Ne)!” (Tekathur, 8)



Çdo mirësi ka një çmim falënderimi. Sahabët e nderuar me edukimin që morën nga Resulullahu (s.a.s.), shkuan në Kinë, shkuan në Semerkand, shkuan në Kajrevan, shkuan në Afrikë për të paguar çmimin e mirësisë së besimit. Në periudhën e **Omer ibn Abdulazizit** (myslimanët) dolën në Spanjë...

✿ Njeriu i mëshirës është njeri që shërben

Shenja dalluese e mëshirës është shërbimi. Një mysliman duhet të çojë mirëqenie në çdo vend që kalon. Ai nuk duhet të shkaktojë dëm, por duhet të bëjë dobi dhe të japë prehje. Nuk duhet të jetë egoist, por duhet të jetë altruist dhe t'i ndajë gjërat me të tjerët. Ai nuk duhet të jetë barrë, por i dashur dhe ndihmës për të tjerët. Domethënë, nuk duhet të jetë barrë për të tjerët, por duhet t'ua mbartë barrën të tjerëve.

I Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

“Besimtari i ngjan bletës. Ha atë që është e pastër (hallall) dhe bën atë që është e pastër (bën vepra me të cilat është i kënaqur Zoti). Ulet në vende të pastra (qëndron me njerëz të devotshëm e të sinqertë) dhe as nuk e thyen, as nuk e prish vendin ku ulet (qëndron).” (Ahmed ibn Hanbel, II, 199.)

Njeriu i mëshirës nuk i shkakton ndonjë dëm vendit ku ulet (qëndron), ha gjëra të pastra dhe jep prodhim të pastër pikërisht si bleta.

✿ **Njeriu i mëshirës nuk lëndon dhe nuk lëndohet**

Sigurisht që më e vështira është të mos lëndohesh.

Allahu i Lartësuar pyet:

“...Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu?..”

(Nur, 22)

Ebu Bekri (r.a.), tha kur zbriti ky ajet fisnik:

“Po, dua që të më falë Allahu.” – dhe e fali edhe atë person që shpifi për nënën tonë, **Hz. Aishen**. Ai vazhdoi t’i jepte lëmoshë atij.

✿ **Njeriu i mëshirës nuk llastohet, nuk hutohet dhe nuk vepron me mospërmbajtje në mirëqenie.** Edhe në varfëri nuk rebelohet, por vesh mburojën e durimit.

✿ **Njeriu i mëshirës është altruist**

Ai sheh me dhembshuri dhe mëshirë jo vetëm veten, fëmijët dhe të afërmit e tij, por edhe;

- Të gjithë umetin e Muhamedit si vëllezër që i ka,

- Të gjithë njerëzimin që është i barabartë me të në humanizëm,

- Të gjitha krijesat nisur nga fakti se ato janë amanet për ne. Ai i sheh ato me dhembshurinë që i ka falur Zoti (xh.xh.) dhe thotë: “Allahu i Lartësuar është Ai që e ka krijuar edhe atë.”



Një ditë i **Dërguari i Allahut** ﷺ, u tha sahabëve të tij:

“Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta ime, se nuk do të hyni në xhenet përderisa të mos keni mëshirë për njëri-tjetrin.”

Sahabët e nderuar i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne të gjithë jemi të mëshirshëm.”

Resulullahu ﷺ, u tha:

“Mëshira (të cilën synoj) nuk është vetëm mëshira ndaj njëri-tjetrit ashtu siç e kuptoni ju. Përkundrazi (unë po flas për) mëshirën e cila përfshin të gjitha krijesat. (Po) mëshira që përfshin të gjitha krijesat!..” (Hakim, IV, 185/7310.)

Njeriu i mëshirës duhet ta eliminojë egoizmin dhe të jetë altruist. Në fillim duhet të thotë: “Së pari vëllai!”, në vend që të mendojë për veten.

Sa bukur shprehet **Hazreti Mevlana**:

“Shemsi (k.s.), më ka mësuar diçka:

«Nëse ka të ftohtë qoftë edhe një besimtar në këtë botë, atëherë nuk ke të drejtë të ngrohesh!»”

E di se në tokë ka besimtarë që kanë të ftohtë. Unë tashmë nuk mund të ngrohem!..”

Edhe **Hazreti Ebu'l-Hasan el-Harakani** ka thënë:

“Një gjemb që i ngulet në gisht vëllait tim në fe nga Turkmenistani e deri në Sham, është ngulur në gishtin tim. Guri që i bie në këmbë dikujt, i shkakton dhimbje këmbës sime. Nëse në një zemër ka brengosje, ajo zemër është zemra ime.”



“Njeriu i mëshirës” është njeriu që mund ta reflektojë kundrejt çdo gjëje pjesën e mëshirës që ka marrë nga Zoti i Madhëruar. Shfaqjet kryesore të kësaj mëshire te besimtari janë:

1. REFLEKTIMI I MËSHIRËS NË BOTËN E MENDIMIT

Njeriu i mëshirës e mbron veten nga shikimi i pamjeve që i nxisin dëshirat vetjake dhe e përmirëson jetën shpirtërore. Ai gjithmonë vështroon pamje që e lartësojnë shpirtërisht.

Sigurisht që për ta arritur këtë është e domosdoshme përsosmëria e jetës shpirtërore... Një zemër e papjekur nuk mund t’i shikojë vitrinat hyjnore.

Mendja dhe zemra, të cilat janë qendra e medimit në trupin e njeriut, janë që të dyja si një hauz. Siç shprehet i ndjeri **Nexhip Fazëlli**, ullukët që e mbushin këtë hauz, janë dy. Në njërin rrjedh dritë, në tjetrin rrjedh papastërti...



Domethënë se, nëse prej këtyre ullukëve vinë vazhdimisht dëshira vetjake, pasione dhe shkujdesje shpirtërore, atëherë bota jonë e brendshme shndërrohet në një kosh mbeturinash. Por, nëse këta ullukë mbushen nga burimet e frymëzimit dhe përshpirtshmërisë, zemrat shndërrohen në det në urtësisë. Ja pra, kështu është gjendja e evliave (miqve) të Allahut.

Për këtë arsye Allahu i Lartësuar kërkon prej nesh një **meditim shpirtëror**. Në të kundërt aftësia e meditimt do të shkatërrohet nëpër dallgët e dëshirave vetjake, sepse një zemër që nuk preokupohet me të vërtetën, e pushton e pavërteta. Edhe në ditët e sotme po vuajmë shumë prej kësaj. Disa programe të papërshtatshme të televizioneve të sotme, pasionet vetjake që i shtojnë reklamat dhe qorrsokakët e internetit, për fat të keq e kanë kapur rob nefsën...

Për një zemër që e ka arritur përsosmërinë çdo gjë në univers, është një vitrinë hyjnore që duhet të vështrohet me shikimin e marrjes së mësimi dhe urtësisë. Zemra e merr patjetër ndikimin e saj prej çdo vitrine. Lulet janë një vitrinë. Kur t'i shohim ata me syrin e zemrës, duhet të mendojmë se:

“Ne e falënderojmë atë që na jep një buqetë. Mirë, por sa duhet ta falënderojmë Allahun Teala i Cili është poseduesi i vërtetë i këtyre buqetave?...



Pranvera është ndryshe, vera është ndryshe, vjeshta është ndryshe, dimri është ndryshe... Çdo stinë ka mirësitë e saj ndryshme...”

Si përfundim, zemra duhet të bëjë kujdes në vështron vitrinat e të Gjithëmëshirshmit, apo vitrinat e shejtanit, sepse, siç janë gjurmët e gishtave një identitet fizik, edhe vitrinat që njeriu vështron dhe mediton rreth tyre, përbëjnë identitetin e tij shpirtëror.

Nga ana tjetër, aftësia e meditimit shpirtëror është një cilësi që e dallon njeriun nga krijesat e tjera dhe e bën atë të ndryshëm dhe më të lartë se ato. **Hazreti Mevlana** thotë:

“O vëlla! Trupi yt për sa i përket mishit dhe kockave (domethënë nga aspekti fizik) është i njëjtë me atë të kafshëve. Andaj ti duhet të bëhesh i gjallë nëpërmjet meditimit. Nëse mediti-imi yt është trëndafil, atëherë edhe ti gjendesh në një bahçe trëndafil. Nëse mendon si ferrë (domethënë, nëse je i mposhtur nga dëshirat vetjake), atëherë je një trung që do të digjesh në zjarr!”

Nisur nga këto që thamë më lart, njeriu i mëshirës e ushqen gjithmonë meditimin e tij duke parë vitrinat e të Gjithëmëshirshmit. Ai e mbron veten nga vitrinat e nefsit dhe shejtanit. Thellohet veçanërisht në meditimin e shfaqjeve të mëshirës



hyjnore, rrymave të fuqisë hyjnore dhe gdhendjeve hyjnore të cilat ekspozohen në librin e universit.

Sepse, përtej perceptimit dhe dëshirës njerëzore, ky univers i shtruar pothuajse me ndjeshmërinë dhe përpikërinë e një dhome nuseje, grimcat, copëzat, qelizat, bimët, kafshët, njerëzit, materia dhe të gjitha gjërat, madje deri tek elementet e mistershme si elektronet dhe protonet brenda atomit kanë ligjet e tyre të mbushura plot e përplot me të fshehta dhe urtësi. Kjo na hap neve një horizont të mrekulueshëm meditimi.

Së fundi, Allahu Teala na e mundësoftë që ta hedhim vështrimin tonë gjithmonë drejt vitrinave hyjnore, inshallah!

Kur shohim universin, vëmë re se gjendemi brenda një bote mejtep. Andaj do të shohim veprën dhe pastaj do të meditojmë rreth Autorit, sepse vepra është dëshmitare e Autorit. Arti tregon fuqinë e Artistit. Besimtari duhet të thellohet në meditimin e artit hyjnor që funksionon me një rregull dhe harmoni të mrekullueshme në gjithësi. Me këtë ndjenjë të thellë shpirtërore ai do të shprehet:

“Aman, o Zot! Ti je larg çdo lloj mangësie dhe të mete.” Këtë do ta thotë me gjithë zemër. Pastaj gjithmonë do të jetë falënderues, mirënjohës dhe përkujtues ndaj Allahut Teala.



2. REFLEKTIMI I MËSHIRËS NË ZEMËR

Besimtari me mëshirën e Krijuesit duhet të fitojë/ marrë një këndvështrim (plot dhembshuri) kundrejt të gjitha krijesave.

Hazreti Muhjiddin ibnu'l-Arabiu ka thënë:

“Sillu me butësi dhe mëshirë ndaj robërve të Allahut. Shfaqe sa më shumë mëshirën dhe butësinë ndaj të gjitha gjallesave e krijesave dhe bëj kujdes e mos thuaj: «Ky është bar. Nuk ka shpirt. Andaj nuk ka asnjë dobi!» Përkundrazi ai ka shumë dobi e mirësi përtej perceptimit tënd. Lëre krijesën në gjendjen e saj dhe mëshirojë me mëshirën që të ka dhënë Krijuesi!”

Një beduin po përpiquej t'i shkundte gjethet e një pemë duke i goditur degët e saj me një shkop që kishte në dorë për t'ua dhënë kafshëve t'i hanin.

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Ma sillni këtu atë beduin. Vetëm se silluni butë ndaj tij dhe mos e frikësoni!”

Kur erdhi beduini, i tha:

“O beduin! hidhi gjethet duke i shkundur me butësi dhe me ëmbëlsi, jo duke e goditur (pemën) e duke e thyer atë!” (Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe, VI. 351.)



Hazreti Aziz Mahmud Hydaji nuk e këputi dot një degë të njomë e cila po bënte dhikër (po përkujtonte Zotin), sepse ai e kuptonte gjuhën e gjendjes së asaj dege.

Gjithashtu besimtari duhet të ketë zemër të butë dhe të mëshirshme. Ai nuk duhet t'i lëndojë të tjerët, nuk duhet të lëndohet prej tyre dhe duhet të jetë falës. Asnjëherë nuk duhet t'ia thyejë zemrën dikujt dhe nuk duhet të preket nga askush.

Sa bukur shprehet **Junus Emre**:

*“Zemra është froni i Zotit,
Zoti e sheh zemrën.
Fatkeqi i të dyja botëve,
Është kushdo që thyen një zemër.”*

Edhe **Hazreti Imam Rabbani** thotë:

“Zemra është fqinji i Allahut. (Zemra është vendi ku shikon Zoti.) Nuk ka asgjë më të afërt me Qenien e Tij të shenjtë sesa zemra. Atëherë mos e lëndoni zemrën qoftë besimtare apo mëkatare, sepse fqinji mbrohet edhe nëse është mëkatar. Aman, qëndroni larg këtij (veprimi), sepse nuk ka mëkat tjetër pas kufrit që bëhet shkak për zemërimin e Allahut Teala, aq sa është lëndimi i zemrës. Kjo, sepse zemra është krijesa më e afërt ndaj Zotit (xh.xh.).” (Imam Rabbani, *Mek-tubat*, III, 326, no: 45.)



Shfaqja e Allahut të Madhëruar ndodh në zemër. Fjala e tevhidit (shehadeti) fillon me “La ilahe”. Së pari duhet të nxirren nga zemra gabimet (zotat e rremë). Zemra nuk duhet të jetë adhuresja e dëshirave të kësaj bote. Pastaj me “Il-lall-llah” zemra bëhet vendi i shfaqjes së cilësive atributeve të bukura të Allahut (xh.xh.).

Njeriu i mëshirës nuk duhet të jetë një njeri që mendon vetëm për veten. Ai duhet të heqë dorë nga vetja për vëllain e tij dhe duhet të jetë altruist.

Kur **Omeri** ﷺ, po hynte në Sham së bashku me skllavin e tij, i tha:

“Radha është e jotja. Hajt, hip ti në deve!”
Skllavi kundërshtoi duke i thënë:

“O kalif! Ata do të më pandehin kalif.” Domethënë se edhe rrobat i kishin të njëjta. Ndërsa Hazreti Omeri e hipi skllavin në deve duke i thënë: *“Radha është e jotja.”* Kurse vetë hyri në Sham duke ecur më këmbë.

Me këtë qëndrim **Omeri** ﷺ, pothuajse po thoshte:

“Te Allahu nuk ka ndonjë dallim ndërmjet meje dhe teje.” Ndryshimi i vetëm është:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَىٰكُمْ



“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (Huxhurat, 13)

Shpirti i besimtarit duhet të mbruhet me mëshirë. Prej shpirtit të tij duhet të shpërthejë mëshirë. Ai duhet të sillet me mëshirë edhe kundrejt një njeriu të privuar nga mëshira dhe duhet të ndjejë keqardhje për të duke menduar për përfundimin e tij të përhershëm. Edhe zullumqarin duhet ta trajtojë si një zog i plagosur. Urrejtjen që ka ndaj mëkatit, nuk duhet ta reflektojë ndaj mëkatarit.

Domethënë se zemra e tij duhet të jetë një vendstrehim (për të tjerët). Në një strofë e cila i përket Ebu Said Ebu'l-Hajrit, por që i atribuohet Hazreti Mevlanës ndoshta për shkak të mendimeve të ngjashme që ka me atë, thuhet:

*“Eja! Eja! Çfarëdo që të jesh, përsëri eja!
Eja edhe nëse je jobesimtar, zoroastrian apo
politeist!
Feja jonë (Islami) nuk është fe e dëshpërimit.
Edhe nëse e prish pendimin njëqind herë,
përsëri eja!”*

Domethënë, zemra duhet të jetë një vend ku të tjerët përmirësohen. Hazreti thotë: “Eja! Kthehu pas! Eja!” Kujt i thërret? U thërret mëkatarëve. U thërret jobesimtarëve. Ai u thotë: “Shikojeni këtu (në zemër) lumturinë që të jep besimi!” “Shikojini këtu (në zemër) shfaqjet e Zotit! Shikojeni mëshirën



e Tij!” Thotë: “Eja përsëri edhe nëse e ke prishur njëqind herë pendimin!”

Së fundi, çfarë tregon kjo? Zemra e besimtarit duhet të jetë një vendstrehim. Ajo zemër duhet të valojë për të tjerët. Në këtë zemër duhet të gjenden hallet e të gjithë njerëzve dhe kafshëve. Ja, ky është dallimi i njeriut të mëshirës...

3. REFLEKTIMI I MËSHIRËS NË GJUHË

Gjuha e besimtarit duhet të jetë gjuha e mëshirës. Ajo duhet t’i gjallërojë zemrat e tjera. Kurrë nuk duhet t’i lëndojë ato. Asnjëherë nuk duhet t’u shkaktojë atyre qoftë edhe vuajtjen më të vogël.

Allahu i Lartësuar thotë:

قَوْلًا كَرِيمًا “Kavlen kerimen”¹, domethënë, thuaj fjalë të butë dhe komplimentuese!

قَوْلًا مَيْسُورًا “Kavlen mejsuran”², domethënë, thuaj fjalë që e kënaq zemrën, që e qetëson shpirtin dhe që i ngushëllon ata!

وَلَا مَعْرُوفًا “Kavlen ma’rufen”³, domethënë, fol me fjalë të bukura dhe gjuhë të ëmbël!

1 Isra, 23.

2 Isra, 28.

3 Nisa, 5, 8.



Përsëri thotë: قَوْلًا مَّعْرُوفًا “Kavlen ma’rufen”⁴, domethënë, fol fjalë me vend dhe të përshtatshme!

قَوْلًا لَّيِّنًا “Kavlen lejinen”⁵, domethënë, thuaj fjalë të butë! Do të flasësh me butësi qoftë edhe kundrejt një zullumqari.

Besimtari duhet të ketë një gjuhë të butë dhe të ëmbël. Një njeri i mëshirës nuk duhet asnjëherë të jetë i vrazhdë, sepse (Zoti thotë):

“...Fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!” (Lukman, 19)

Besimtari nuk duhet të ketë një gjuhë lënduese dhe të vrazhdë, por një gjuhë që i jep shërim zemrës dhe që e përmirëson gjendjen.

Hazreti Ebu’l-Hasan el-Harakani thotë:

“Një besimtar që e kalon kohën nga mëngjesi deri në mbrëmje pa lënduar një vëlla në fe, është sikur atë ditë ka jetuar me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), deri në mbrëmje. Nëse e lëndon një besimtar, Allahu Teala nuk ia pranon atij adhurimin e asaj dite.”

Edhe **Hazreti Mevlana** thotë:

“Në krye të ujit të ëmbël gjenden shumë

4 Ahzab, 32.

5 Taha, 44.



njerëz.” Nëse bëhemi si uji i ëmbël, atëherë do të bëhemi njerëz të mëshirës.

Njeriu i mëshirës gjithashtu duhet të ketë një gjuhë ndërtuese dhe jo shkatërruese. Domethënë, duhet të ketë jo një gjuhë që ndërton urat e miqësisë dhe dashurisë ndërmjet zemrave e jo një gjuhë që shkakton prishje e përçarje. Ai duhet të ketë një gjuhë që bën paqe, siguri dhe miqësi e jo një gjuhë që shkakton debate.

Besimtari duhet t’i shmanget debatit dhe nuk duhet të qëndrojë në vende ku bëhet debat, sepse në ajetin fisnik thuhet:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen (pa i lënduar): “Paqe qoftë!” (Furkan, 63.)

4. REFLEKTIMI I MËSHIRËS TE SYTË

Besimtari nuk duhet të përçmojë dhe nënçmojë asnjë njeri. Ai nuk duhet t’i shohë të tjerët me një shikim plot smirë dhe lakmi.

Shikimi i çdo njeriu është sipas gjendjes së zemrës. Për këtë arsye, një zemër e mburitur me mëshirë, është mëshirë për atë që shikon. Ky është një shikim që ngjan me shikimin e miqve të Allahut...

Ndërsa shikimi i një lakmitari i cili e ka zemrën të kapluar nga sëmundja e smirës, e sëmur edhe njeriun që ka përballë.



Andaj shikimet e njeriut të mëshirës duhet të jenë plot e përplot me butësi dhe mëshirë. Ai u jep të tjerëve energji pozitive me shikimin e tij plot optimizëm. Domethënë i gjallëron të tjerët edhe me shikimin e tij.

5. REFLEKTIMI I MËSHIRËS TE DUART

Duart e njeriut të mëshirës janë gjithmonë në gjendje infaku (japin për hir të Zotit). Këto duar janë duar që i ledhatojnë kokën jetimit, i plotësojnë nevojën të varfrit dhe ia bëjnë fytyrën të qeshë të skamurit.

Askujt nuk i ndodh ndonjë e keqe prej këtyre duarve. Përkundrazi, të gjitha krijesat kanë dobi prej tyre.

Përsëri këto janë duar që nuk i drejtohen asnjëherë haramit, që bëjnë kujdes ndaj shpërdorimit dhe që nuk e kursejnë hallallin. Domethënë, që e përgatisin kapitalin e ahiretit duke bërë infak. Këto janë duar që i heqin pengesat nga rruga, që ndihmojnë, që ua shtrëngojnë dorën të tjerëve dhe që nuk lodhën duke bërë mirësi.

6. REFLEKTIMI I MËSHIRËS TE POZITA

Njeriu i mëshirës sillet kundrejt njerëzve të tjerë sipas gjendjes së tyre dhe jo sipas pozitës dhe sta-



tusit të tyre. Nëse ai vetë gjendet në një pozitë të lartë, atëherë pozita e tij është një vend ku të varfrit dhe nevojtarët mund të shkojnë dhe ta shprehin gjendjen e tyre aq sa edhe të pasurit. Sepse njeriu i mëshirës e konsideron si mirësi pozitën në të cilën gjendet. Andaj nuk kaplohet nga mendjemadhësia, por e shfrytëzon atë për të përhapur drejtësi, për të bërë shërbim dhe për të shfaqur mëshirë.

Para se **Ebu Bekri** (r.a.), të bëhej kalif, milte delet e vajzave jetime që gjendeshin përreth dhe ua plotësonte atyre nevojat në mënyrë bujare.⁶ Ai i vazhdoi këto shërbime edhe pasi u zgjodh kalif.

Kur **Hazreti Jusufi** عليه السلام, administronte thesarin e shtetit, shpërndante ushqime ndërsa vetë ishte i uritur, në mënyrë që ta përhapte mëshirën në pozitën që kishte ardhur. Ai mbante pehri, në mënyrë që ta kuptonte gjendjen e të uriturve. Kështu, kur i shkuan vëllezërit të cilët i patën bërë padrejtësi, ndjeu keqardhje edhe për ta dhe në vend që të merrte hak, i fali dhe u tregua bujar ndaj tyre.

7. REFLEKTIMI I MËSHIRËS TE PASURIA

Ndarja e gjërave me të tjerët, bujaria dhe infaku duhet të jenë natyra e karakterit të një besimtar.

⁶ Shik. Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 80; Sarëçam, Hz. Ebu Bekri, fq. 82.



Besimtari duhet ta dijë se Allahu Teala është zotëruesi i vërtetë i çdo gjëje. Ai duhet ta perceptojë pasurinë si një amanet që i është dhënë për një kohë të caktuar. Kurse veten duhet ta shohë pothuajse si një arkëtar. Edhe pasurinë që i është dhënë amanet duhet të përpiqet ta shndërrojë në kapital të lumturisë së botës së përtejme.

Mallin dhe pasurinë duhet t'i përdorë jo për t'u mburrur dhe për t'i përçmuar njerëzit, por për t'i fituar zemrat (e njerëzve) dhe për të marrë lutjet e tyre. Edhe kur të japë, duhet të ketë ndjeshmërinë për ta falënderuar marrësin, sepse **Hazreti Ebu'l-Lejs Semerkandi** ka thënë:

“Për sa i përket çështjes së infakut, në të vërtetë ai që jep duhet të ketë një ndjeshmëri të madhe falënderimi kundrejt atij që merr, sepse ai që jep, falë atij që merr, do të shpëtojë nga shumë sprova, fatkeqësi dhe vështirësi në këtë botë dhe në botën tjetër. Më e rëndësishmja nga të gjitha, do të fitojë kënaqësinë e Allahut.”

8. REFLEKTIMI I MËSHIRËS TE PERSONALITETI

Besimtari duhet të jetë një person i mirë në çdo situatë. Në hadithin fisnik thuhet:

“Mysliman është ai njeri prej gjuhës dhe dorës



së të cilit nuk kanë dëm myslimanët...” (Buhari, Iman, 4-5)

Domethënë (besimtari) duhet të jetë një person-alitet që fal paqe e siguri në vendin ku gjendet...

Ai duhet të përpiqet të bëhet përfaqësuesi i **të Dërguarit të Allahut** ﷺ, i cili ishte mëshirë për botët në kohën dhe vendin ku jetoi. Duhet të shndër-rohet në mëshirë si shembulli i shiut për zemrat e shkretuara.

Kjo është shumë e rëndësishme veçanërisht në ditët e sotme. Shteti u jep “stimulim vështirësie” atyre që punojnë në kohë dhe vende të rrezikshme/vështira. Ndërsa Allahu Teala i quan **“karzi hasen / borxh i bukur”**⁷ përpjekjet e besimtarëve që je-tojnë në periudha të vështira. Allahu (xh.xh.), jep përgëzimin e një shpërblimi të madh për këto për-pjekje. Edhe sot, Allahu e di më së miri, mendoj se gjendemi në ditë të tilla.

Të qenët njeri i mëshirës kërkon sakrificë, shër-bim, kërkon moral të lartë dhe posedimin e një gjendjeje me të cilën (besimtari) ndikon te të tjerët.

Një ditë **Omeri** ﷺ, tha:

“Bëhuni ftuesit e heshtur të njerëzve!” E py-etën:

7 Shih. Bekare, 245; Hadid, 11, 18; Maide, 12; Muzzemmil, 20; Tegabun, 17.



“O kalif! Si mund të bëhemi ftues pa folur?”

Omeri ﷺ, tha:


“Me gjendjen dhe moralin tuaj...”

Domethënë bëjeni predikimin me mënyrën e (mrekullueshme) të jetesës, me mirësjellje, më hijeshi dhe me çiltërsi...

Përgjatë gjithë historisë gjithmonë kështu ka ndodhur. Kosova dhe Bosnja u çliruan. Në sajë të politikës së vendosjes së njerëzve për të banuar, populli i dëlirë i Anadollit u vendos atje për të banuar. Kur boshnjakët e panë gjendjen e dëlirë dhe mënyrën e pastër të jetesës të popullit të Anadollit, pothuajse të gjithë prej tyre u bënë myslimanë. Pothuajse edhe nëntëdhjetë e pesë për qind e shqiptarëve u bënë myslimanë. Edhe sot kjo është ajo që Islami pret prej nesh.

Allahu na e mundësoftë të gjithëve që të bëhemi
“njerëz të mëshirës”!





Shoqëria e Mëshirës

*Kulmi i personalitetit të njeriut që ka ndërtuar civilizimi
Islam përbëhet nga “njerëzit e vakëfit” të cilët i kanë
shndërruar zemrat e tyre në një vend mëshire që i përfshin
të gjitha krijesat me butësi.*

*Njerëzit mund ta vazhdojnë jetën në prehje dhe paqe
vetëm falë pothuajse një rrjete butësie që e thur shoqëria e
“njerëzve të vakëfit”. Në të njëjtën mënyrë, edhe nderi dhe
madhështia e shoqërive në shumicën e rasteve është sa jeta e
këtyre njerëzve të vakëfit...*

Pyetja 2

Çfarë mund të thoni në lidhje me strukturën e shoqërisë së civilizimit Islam? Çfarë strukturre shoqërie kanë ndërtuar gjyshërit tanë në histori? Si mund ta gjallërojmë përsëri atë strukturë shoqërore në botën e ditëve të sotme dhe atë strukturën morale në jetën shoqërore?

Allahu i Lartësuar thotë në ajetin e 110-të të sures Al Imran:

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...”

Ndërsa në ajetin e 143-të të sures Bekare thotë:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë (dëshmitarë të Islamit, të përfaqësoni Islamin) përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...”

Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar kërkon që ne, robërit e Tij, të bëhemi përfaqësuesit e Zotit në tokë dhe një umet i drejtë që përhapim mëshirë nga zemra.

Edhe miqësinë e Zotit mund ta fitojmë në këtë mënyrë. Gjithashtu në këtë mënyrë, inshallah, mund të arrijmë mirësitë dhe nderimet e miqësisë me Zotin (xh.xh.), nëpër ato shtigje e ditë të vështira duke marrë përgëzimin e ajetit fisnik në të cilin thuhet:



أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (Junus, 62)



Vetëm kur njerëzimi të marrë personalitetin dhe karakterin Islam del në pah “Shoqëria e Mëshirës”. Kështu ka qenë:

- Periudha e Epokës së Lumturisë (Periudha e të Dërguarit të Allahut a.s.),
- Periudha e kalifëve të drejtë,
- Periudha e Omer ibn Abdulazizit të emevive,
- Tre shekujt e parë të Andaluzisë-Spanjës,
- Tre shekujt e parë të osmanëve...

Ja pra, në të gjitha këto periudha njerëzimi ka dëshmuar shfaqjet kulmore se si duhet të jetë “Shoqëria e Mëshirës”.

Kjo “Shoqëria e Mëshirës” ka ndërtuar një civilizim të madh virtytesh në këtë botë. Çfarë civilizimi ishte ky?

-Ishte një civilizim në humanizëm, -krejtësisht i kundërti i këtij të sotmit,

-Ishte një civilizim në moral,



-Ishte një civilizim në dije,

-Ishte një civilizim në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Kjo (shoqëria e mëshirës) solli një civilizim të rrallë në art, arkitekturë dhe letërsi.

Civilizimi gjendet vetëm në Islam. Sot nuk gjendet ndonjë civilizim në ndonjë vend tjetër! Le të pyesim ndonjë afrikan dhe t'i themi: "A ka pasur ndonjëherë civilizim në vendin tuaj?" Le t'i pyesim se si janë çuar si skllevër në Amerikë. Le t'i pyesim se si janë kolonizuar vendet e tyre, në mënyrë që t'u bien maskat që kanë në fytyrë ata që thonë se kanë sjellë civilizim! Cili civilizim?!

Gjithashtu, në Luftën e 2-të Botërore janë vrarë tridhjetë milion njerëz. Në vitin 1945 dy qytete të Japonisë u kthyen në qymyr (u shkrumbuan). Njerëzit, gratë, fëmijët, pemët, toka... Të gjithë u bënë shkrumb e hi. Afërsisht gjashtë milion çifutë u ekzekutuan nëpër dhomat e gazit, u dogjën nëpër furra dhe u bënë sapunë!..

Cili civilizim është ky?! Çfarë civilizimi është ky?!

Këtë po e shohim edhe në ditët e sotme. Le të shohim Sirinë, të shohim Jemenin, të shohim Egjiptin, të shohim Palestinën, të shohim Gazën... Cili civilizim është ky?! Çfarë civilizimi është ky?! Mos vallë civilizimi vjen duke i shtypur njerëzit, duke



ia shkukur rrënjët mëshirës dhe duke e kthyer tokën në vend zie?! Civilizimi i vërtetë gjendet në Islam...

ÇFARË NJERËZISH ISHIN NJERËZIT E CIVILIZIMIT ISLAM?

Një shembull:

Omeri , para Islamit ishte një njeri me natyrë të ashpër dhe të vrazhdë. Ky Omer u zhduk dhe në vend të tij erdhi **“Hazreti Omeri”** i cili i kishte sytë me lot, zemrën të mbushur plot me dhembshuri e mëshirë, i cili mendonte gjithmonë për lumturinë e umetit dhe që posedonte një vetëdije të lartë përgjegjësie. Ai ka thënë:

*“Nëse humbet një qengj buzë Eufratit, kam frikë se për shkak të tij Allahu do të më marrë në llogari mua.”*⁸ Ai gjithmonë e mbante veten nën një kontroll të rreptë.

Gjatë natës ecte nëpër lagje me një thes ushqimesh në shpinë dhe shkonte pranë të dobëtëve dhe të varfërve.

Ai nuk i linte vetëm jetimët, të vobektët dhe të vetmuarit. Nuk i gjente qetësi zemra derisa t’i ngushëllonte zemrat e thyera, t’ua fshinte lotët (njerëzve të tillë) dhe t’i bënte të buzëqeshnin.

8 Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VIII, 153.



Ndjeshmëria ndaj të drejtës së njeriut dhe përgjegjësia e mirësive që ka dhënë Allahu Teala

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, edhe kur po ndërronte jetë, ka theksuar shumë dy gjëra. Enesi رضي الله عنه, ka thënë:

“Kur po ndërronte jetë Resulullahu ﷺ, ne gjen-deshim pranë tij. Ai na tha tri herë:

«Kini frikë nga Allahu në lidhje me namazin!»
Pastaj na tha:

«Kini frikë Allahun në lidhje me njerëzit që i keni nën urdhër! Kini frikë nga Allahu në lidhje me dy njerëz të dobët: Gruaja e ve dhe fëmija jetim. Kini frikë Allahun në lidhje me namazin!»

Pastaj filloi të thoshte duke e përsëritur: «*Namazi, namazi...*» (Edhe kur zëri nuk i dëgjohej dot), vazhdoi ta përsëriste këtë me zemër derisa i doli shpirti i bekuar.” (Bejhaki, Shuab, VII, 477.)

Domethënë se **i Dërguari i Allahut** ﷺ, për shpëtimin e umetit të tij, pra për shpëtimin tonë ka urdhëruar që të kemi kujdes veçanërisht ndaj namazit, ndaj të drejtave të atyre që i kemi nën urdhra dhe t’u dalim për zot grave të veja, jetimëve dhe njerëzve të vetmuar.

Sot për fat të keq, bota është e mbushur me gra të veja, jetimë dhe njerëz të vetmuar...



Përsëri do të jap një shembull në lidhje me ndjeshmërinë e Hazreti Omerit ﷺ ndaj të drejtës së njeriut:

Ijas ibn Seleme ﷺ, transmeton nga babai i tij:

“Hazreti Omeri ﷺ, kishte dalë në treg. Në dorë kishte një shkop. Sigurisht që atë kohë rrugët ishin të ngushta. Ai më tha duke e lëvizur shkopin drejt meje: *«Mos e mbyll rrugën e myslimanëve! Hape rrugën!»* Shkopi më preku në fund të rrobës. Kur u takuam përsëri një vit më vonë, më pyeti:

«Seleme! A do të shkosh në haxh?» Kur iu përgjigja: *«Po!»*, më kapi për dore dhe më çoi te shtëpia e tij. Më dha 600 dërhëmë dhe më tha:

«Këta përdori përgjatë rrugës së haxhit. Dije se këta janë si kompensim për shkopin që ta drejtova!» Unë i thashë:

«O prijësi i besimtarëve! Nuk po më kujtohet çështja e shkopit për të cilën po më flet.» Ai më tha:

«Ndërsa unë nuk e kam harruar!» (Taberi, Tarih, IV, 224.)

Edhe kjo është shumë e rëndësishme. Nesër në anën (botën) tjetër do të gjendemi ballë për ballë me të drejtat e njerëzve...

Atje do të na thuhet: **“Lexoje librin tënd! Ti**



mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra,

14) Ato dosje do të hapen. Bazuar në ato dosje:

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ

وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”

(Zelzele, 7-8)

Thërrmijat atë ditë do të hidhen para nesh si shi... Për këtë arsye, **i Dërguari i Allahut** ﷺ, ka thënë në hadithet fisnike:

“O njerëz! Kushdo që të ketë ndonjë hak te dikush, le t’ia kompensojë atë menjëherë dhe le të mos mendojë në formën: “(Po e bëra këtë), do të poshtërohem në këtë botë! Dijeni mirë se poshtërimi në këtë botë është shumë më i lehtë se ai në botën tjetër.” (Ibn Esir, el-Kamil, II, 319.)

“Kushdo që i ka bërë ndonjë padrejtësi në lidhje me nderin, namusin apo pasurinë e vëllait të tij në fe, le të marrë hallallëk nga ai para se të vijë dita e kiametit në të cilën nuk ka florinj dhe argjende. Përndryshe, nëse do të ketë vepra të mira, do t’i merren sevapet në raport me padrejtësinë që ka bërë (dhe do t’i jepen atij që i ka bërë



padrejtësi). Nëse nuk ka të mira, do të merren mëkatet e vëllait që i është bërë padrejtësi dhe do t'i jepen atij.” (Buhari, Mezalim 10, Rikak 48.)

❦ Si doli në pah një njeri i civilizuar me edukimin e **të Nderuarit tonë** ﷺ, nga gjendja kaotike e xhahilijetit (koha para ardhjes së Islamit)? Edukimi i **Ebu Bekrit** ﷺ, ishte ndryshe. Edukimi i **Omerit** ﷺ, ishte ndryshe. Edhe edukimi i **Vahshiut** abisinas që vrau **Hamzanë** ﷺ, ishte ndryshe. Pasi Vahshiu nga Abisinia u bë mysliman, zemra i dridhej kur mendonte:

“Vallë, a do të më falë Allahu?” Këto përpëlitje (pendimi) filloi t'i përjetonte vazhdimisht në botën e tij shpirtërore.

❦ Devotshmëria e vajzës që shiste qumësht... Në cilën shkollë u edukua kjo vajzë? Kur nëna e saj i tha:

“Bijë! Hidhi qumështit ujë! Mos u bëj merak, sepse kalifi nuk mund të të shikojë.”, ajo ia ktheu:

“Nënë! Kalifi nuk mund të më shikojë, por Allahu më shikon.”

❦ **Omer ibn Abdulazizi**, rahmetull-llahi alejh... Tregon bashkëshortja e tij, Fatimja:

“Një ditë shkova te Omer ibn Abdulazizi. Ai ishte ulur në vendin ku po falej, kishte vendosur dorën në ballë, qante pa reshtur dhe lotët i lagnin faqet.



E pyeta se përse ishte në atë gjendje. Më tha:

“Fatime! Barra më e rëndë e këtij umeti është në supet e mia. Të uriturit, të varfrit, të sëmurët që nuk i gjejnë dot ilaçet, ata që nuk kanë rroba për të veshur, jetimët kokulur, gratë e veja që janë lënë të vetme, të dhunuarit që nuk e kërkojnë dot të drejtën e tyre, robërit myslimanë nëpër vendet e kufrit dhe kurbetit, të moshuarit nevojtarë që nuk kanë fuqi të punojnë për të siguruar nevojat, kryetarët e familjeve të varfra që përbëhen nga shumë pjesëtarë...

Kur mendoj për vëllezërit e mi besimtarë në këtë gjendje që janë nëpër vende të afërta dhe të largëta, e ndiej veten shumë keq. Nëse Zoti do të më marrë në llogari nesër për këta, nëse i Dërguari i Allahut ﷺ, do të më qortojë dhe do të ankohet prej meje, si do të përgjigjem unë?!»” (Ibn Kethir, 9/201.)

Bashkëshortja e tij, Fatimja e vazhdon fjalën e saj duke u shprehur:

“Ibadeti i tij ishte aq sa i juaji. Vetëm se natën në shtrat kishte një gjendje të atillë që, për shkak të meditimit rreth frikës ndaj Allahut dhe llogarisë në ditën e gjykimit, fillonte t’i rrihte zemra fort. Ai përpëlitej si një zog që ka rënë në ujë dhe që mbahet në dorë. Unë nuk i rezistoj dot kësaj gjendjeje të tij. Andaj ia hidhja jorganin sipër dhe thosha me vete:



«Ah sikur të mos na ishte dhënë neve përgjegjësia e udhëheqjes! Ah sikur largësia ndërmjet nesh dhe asaj detyre të ishte sa largësia ndërmjet diellit dhe tokës!»



Çdo civilizim nxjerr në pah tipin e njeriut të tij. Ky tip njeriu përfaqëson harmoninë me natyrën dhe karakterin e atij civilizimi që i përket.

Civilizimi Islam është një pikë kulmore që është arritur një herë në historinë e njerëzimit. Shkaku i kësaj, falë Islamit, është pajisja e aftësive të natyrshme me dijen dhe urtësinë hyjnore. Domethënë, njerëzit e zgjedhur të kësaj shoqërie i patën mbushur zemrat e tyre me dije e urtësi të vërtetë duke i mënjeluar problemet vetjake.

Bashkimi i aftësisë së natyrshme të popullit tonë me frymëzimin spiritual dhe përshpirtshmërinë, nxori në pah pikën kulmore të një civilizimi të përsosur. Emri historik i kësaj pike kulmore padyshim që është **“Perandoria Osmane”** e cila udhëhoqi për 620 vjet me radhë.

Gjyshërit tanë osmanë ishin një shoqëri mëshire që përpiqej për ta vazhduar metodën e mëshirës së Epokës së Lumturisë.

Me të vërtetë gjyshërit tanë kanë bërë në të



njëjtën kohë ndërtimin material dhe atë shpirtëror. Ata edukuan personalitete me horizont të gjerë të cilët çlirimin e vendeve e bënë për çlirimin e zemrave.

Këshillat që **Osman Gazi**, ndërtuesi i vërtetë i Perandorisë Osmane, i bëri të birit dhe si rrjedhojë të gjithë burrave të shtetit që do të vinin në të ardhmen, janë një shprehje e qartë e asaj që thamë më lart. Ai njeri i madh thoshte:

“Bir! Dije se profesioni ynë është rruga e Allahut dhe qëllimi ynë është përhapja e fesë së Tij (të bëhemi shkak për udhëzimin e të tjerëve). Kauza jonë nuk është një grindje e thatë dhe një kauzë për të sunduar botën, por është «i’la-ji kelimetu’ll-llah», domethënë lartësimi i fesë së Allahut (çlirimi i zemrave).”

Orhan Gazi preferonte ta realizonte që çlirimin e vërtetë në zemër, duke thënë: *“Humanizmi është më i mirë se lufta!”* Ai i bënte të përjetshme çlirimet me anë të çlirimeve të zemrave. Në vendet që çliroheshin, si fillim dërgonte për të banuar njerëz të përkushtuar ndaj fesë dhe besimtarë e besimtare të devotshme. Predikimi që ata bënë me jetesën dhe gjendjen e tyre shembullore, bëhej shkak për udhëzimin e popullit të vendit (të çliuar).

Orhan Gazi i dha këtë këshillë birit të tij, Muratit:



“Udhëheqja e osmanëve në dy kontinente nuk është e mjaftueshme, sepse kauza e i’la-ji kelimetull-llahut është një kauzë që nuk e nxënë dot dy kontinente!”

Nisur nga kjo **Sulltan Murati** kaloi në Evropë. Shkoi deri në **Kosovë** dhe aty ra dëshmor.

Murat Hani I, ndërkohë që kishte shumë mirësi e rehati në Bursa, e la atë rehati, shkoi deri në Kosovë dhe ra dëshmor për lartësimin e fjalës së Allahut. Kur dy ushtritë dolën ballë për ballë njëra-tjetrës në fushën e Kosovës, ai u lut:

“O Zot! Sot le të jetë festë dhe kurhani i kësaj feste le të jem unë!”

Ja pra, Sulltan Murati ka pjesë (nga sevapet) dhe (sevap si) lëmoshë e vazhdueshme për çdo ezan që thirret dhe çdo namaz që falet në ato toka sot.

Përse i çoi Sulltan Murati i Parë njerëzit e dëlirë të Anadollit në ato toka? Përse brezat që erdhën më pas e zbukuruan çdo vend me kube të ndritshme?

Të gjitha këto (vepra) padyshim se ishin për t’u bërë **“një umet i mirëfilltë”** për të **Nderuarin tonë**, për të shtuar **“shoqërinë e mëshirës”** dhe për t’u bërë një umet që fton në mirësi. Ishin për të ndjekur gjurmët e **Ensarëve** dhe **Muhaxhirëve** të cilët Allahu na i paraqet si një **“brez shembullor”**.



Allahu i Lartësuar në ajetin e 100-të të sures Teube, pasi flet për muhaxhirët/mekasit dhe ensarët/medinasit, na urdhëron edhe ne që të bëhemi prej **“të devotshmëve që i ndjekin ata”**, domethënë na urdhëron që të ndjekim gjurmët e tyre.

Sikundër kësaj, (Zoti) për t'i qortuar ata që mashtrohen nga stolitë, jeta luksoze dhe rehatia e kësaj bote dhe që qëndrojnë larg përpjekjeve për të fituar kënaqësinë e Allahut, thotë në ajetin e 195-të të sures Bekare: **“...Mos e hidhni veten në rrezik (me duart tuaja)!..”**

Për këtë arsye sahabët e nderuar deri në frymën e fundit e lanë rehatinë e vreshtave të hurmave në Medine dhe shkuan deri në Semerkand e Kinë për të paguar çmimin e mirësisë së besimit që ua dha Allahu (xh.xh.).

Në periudhën e **Omer ibn Abdulazizit** (mysli-manët) dolën në Spanjë. Me shtatë mijë ushtarë u mposht ushtria e Spanjës që përbëhej nga 95 mijë ushtarë.

Ukbe ibn Nafi shkoi deri në Kajrevan dhe tha:

“O Zot! Po të mos më dilte para ky det i madh, do të vazhdoja të përparoja në vendet që do të më dilnin përpara duke bërë xhihad në rrugën Tënde. Por ja që më doli përpara ky det i madh!”

Kur u kthye nga lufta e Egjiptit, **Javuz Sulltan Selimi** tha:



“Zemra ma do që të shkoj në Andaluzi nga veriu i Afrikës dhe më pas të kthehem përsëri në Stamboll nga Ballkani!”

Ja pra, çfarë ishte kjo? Horizonti i udhëzimit të një myslimani!.. Shqetësimi i tij për udhëzimin (e të tjerëve). Nuk ishte derdhja e gjakut, por çlirimi i zemrave të njerëzve...

Të gjitha këto përpjekje ishin gjithmonë shfaqjet e shqetësimit **“për të mos e hedhur veten në rrezik”**.

I gjithë halli i tyre ishte lartësimi i fjalës së Allahut dhe ta prezantonin njerëzimin me lumturinë dhe paqen e Islamit. Ata thërrisnin për te e vërteta e mirësia dhe përpëliteshin për shpëtimin e përherëshëm të njerëzimit.

Kur **Fatih Sulltan Mehmet Hani** po shkonte në luftën e Trabzonit, nëna e Uzun Hasanit, zonja **Sara** i tha:

“Bir! Ti je han bir i hanit! Je një udhëheqës i lartë! A ia vlen që të përballesh me gjithë këtë vështirësi për një kala të vogël si ajo e Trabzonit?”

Ndërsa Fatihu i dha këtë përgjigje:

“O nënë e moshuar!.. Mos pandeh se gjithë këto vuajtje që po heqim janë për një copë tokë të thatë. Dije se e gjithë përpjekja jonë është



për t'i shërbyer fesë së Allahut, për t'i drejtuar njerëzit në rrugën e udhëzimit dhe që nesër të mos na nxihet fytyra kur të dalim në audiencën hyjnore. A e meritojmë të na thonë veteranë nëse preferojmë rehatinë e trupit duke mos pranuar që të përballemi me disa vështirësi ndërkohë që kemi mundësi ta predikojmë dhe lartësojmë Islamin? Me çfarë fytyre do të dalim në audiencën hyjnore nëse nuk ua shpiem Islamin jobesimtarëve dhe nëse nuk e ndalojmë harbutërinë e tyre?!”

Pasi Sulltan Mehmet Fatihu e çliroi Bosnjën, dërgoi atje njerëzit e pastër, të edukuar në mënyrë të mirëfilltë dhe të devotshëm të Anadollit dhe i vendosi aty për të banuar. Të gjithë boshnjakët fatlumë që u mahnitën nga Islami që përfaqësonin ata, u bënë myslimanë.

Domethënë se, gjyshërit tanë kanë rendur nga lufta në luftë për të lartësuar fjalën e Allahut dhe jo për të rritur hartën.

Në luftërat që bënë sahabët e nderuar dhe gjyshërit tanë që kanë ndjekur gjurmët e tyre, nuk shkuan për të marrë tokë, por për të çuar mirësi. Të gjitha mundësitë i shndërruan në shërbim, mirësi e begati për njerëzit e vendeve që çliroheshin. Vendet e çliuara u ndërtuan me virtytet e Islamit dhe arritën begatinë. Zemrat u gjallëruan.



Është e vërtetë se pushtimet e mëdha përgjatë historisë kanë shkaktuar emigrime të mëdha, sepse populli shkon drejt vendeve më të sigurta për shkak të padrejtësisë, plaçkitjes dhe dhunës së pushtuesve. Pikërisht si ata që shkuan në Anadoll duke ikur prej pushtimeve mongole...

Ndërsa në vendet e mëdha ku kanë ndodhur çlirimet islame, nuk është përjetuar një arratisje e tillë. Madje edhe të huajt që dhunoheshin në tokat ku jetonin, strehoheshin në vendet islame.

Barbaros Hajredin Pasha i çoi në Stamboll çifutët që po arratiseshin nga masakra në Spanjë. Ndërsa populli i Stambollit i mirëpriti dhe i ndihmoi ata duke thënë “këta janë të shtypur”. Një pjesë prej tyre u bënë myslimanë.

Islami nuk ia ka ndërruar askujt fenë me imponim dhe nuk ia ka marrë pasurinë. Përkundrazi, liria dhe siguria e popullit ishte borxh për shtetin kundrejt një takse të caktuar.

Do t’ju jap një shembull shumë mësimdhënës nga historia:

Heroi i Plevnes, **Osman Pasha**, pati mbetur për gjashtë muaj me radhë nën rrethimin e rusëve. Edhe pse i mbaruan furnizimet, nuk u dorëzua. Atij nuk i mbeti zgjidhje tjetër përveçse të organizonte operacionin për t’u arratisur. Në ato momente thirri të parët e bullgarëve dhe u tha:



“Unë pata marrë taksë prej jush për t’ju mbrojtur, por tashmë nuk më ka mbetur fuqi për t’ju mbrojtur. Për këtë arsye, pa jua kthej taksat që ju kam marrë.”

Si përfundim, myslimani duhet të jetë shembull me çdo gjendje të tij. Ai duhet të jetë dëshmitari i Allahut në tokë.

Në histori ka shumë shembuj si ky. Qëllimi kryesor i çliruesve myslimanë përgjatë historisë nuk ishte t’i zaptonin vendet duke e derdhur gjakun lum, por të çlironin zemrat duke eliminuar padrejtësitë.

Për këtë arsye, njerëzit e vendeve të çliuara bëheshin admirues të çliruesve të tyre. Në shumë vende ata i ftuan çliruesit e tyre.

Për shembull, kur gjatë çlirimit të Stambollit fisnikët bizantinë po diskutonin se çfarë do të bënin, disa prej tyre propozuan që të kërkonin ndihmë prej Romës. **Notarasi**, i cili ishte prej fisnikëve bizantinë të asaj kohe, u shpreh:

“Në vend që të shoh kapelën e kardinalëve (që na kanë bërë padrejtësi) në Stamboll, preferoj të shoh çallmën e turqe!..”

Reformisti gjerman, **Martin Lutheri**, i cili themeloi rrymën protestante duke i kundërshtuar padrejtësitë dhe gabimet e tmerrshme dhe aspak logjike të krishterimit i cili kishte dalë nga binarët, është shprehur:



“O Zot! Silli turqit e mëdhenj sa më parë, në mënyrë që falë tyre të përfitojmë nga drejtësia Jote hyjnore!..”

Gjithashtu **Martin Lutheri** i qortoi me këto fjalë udhëheqësit (e krishterë) që e shfrytëzonin pa mëshirë popullin e tyre:

“Më mirë jetoj nën udhëheqjen e osmanëve, sesa të jetoj nën udhëheqjen e princave, agallarëve të tokave dhe borgjezëve sy pangopur, sepse ata janë shumë më të mëshirshëm se ju ndaj të varfërve.”

Edhe beu i Bogdanit, **Stefani**, i cili mori titullin “Kalorësi i Krishterë” ngaqë luftoi shumë kundrejt osmanëve në shekullin e 16-të, por që ishte i vetëdijshëm për drejtësinë e pashoqe të osmanëve, u tha kështu bijve të tij kur po dergjej në shtratin e vdekjes:

“Ndoshta shumë shpejt do të keni nevojë për mbrojtje. Kur të bini në këtë gjendje, kurrë mos u afroni te rusët, sepse do t’ju zhdukin! Por strehohuni te osmanët, sepse ata janë të drejtë dhe të mëshirshëm!..”

Gjyshërit tanë ishin burim i paqes në çdo vend ku shkonin. Madje kjo fjalë që thuhet në **Poloni**:

“Përderisa kuajt osmanë të mos pinë ujë në lumin Vistul, ky vend nuk do ta arrijë lirinë dhe pavarësinë.”, është shndërruar në një shembull.



Në katin më të lartë të ndërtesës historike pesë katëshe të bashkisë që gjendet në qendër të qytetit Leiden të Hollandës, ndodhet busti i **Barbaros Hajredin Pashës**. Ky bust është bërë si shenjë mirënjohjeje (ndaj Barbarosës), ngaqë planet e spanjollëve për të zaptuar tokat e Hollandës u prishën për shkak të frikës nga Barbarosa i cili i mbronte hollandezët. Nën bust hollandezët kanë gdhendur me shkronja të mëdha dhe të praruara shprehjen: **“Në emër të turkut të artë.”**

Përfundimisht, përgjatë historisë ne kemi theme-luar një civilizim të tillë. Jemi ne ata që e kanë ndërtuar civilizimin e vërtetë.



Civilizimet mund t'i krahasojmë me ato që kanë lënë nga e kaluara deri më sot:

Shtetet që kanë bërë pushtime të mëdha përgjatë historisë, kanë ndërtuar saraje dhe monumente madhështore dhe të jashtëzakonshme nëpër qendrat e vendeve që pushtonin. Civilizimi perëndimor ka lënë gjykatat e inkuizicionit.

Ato që kanë mbetur sot nga Roma e lashtë, janë arenat e padrejtësisë në të cilat jepnin shpirt ndërmjet dhëmbëve të luanëve skllevërit prej të krishterëve të parë që luftonin për mbrojtjen e te-vhidit (njësimit të Zotit).



Ato që kanë mbetur nga Egjipti i faraonëve janë piramidat madhështore e të zymta të cilat janë ndërtuar me tirani e padrejtësi për të kundërshtuar përkohshmërinë dhe që mbajnë erë mendjemadhësie.

Ato që kanë mbetur nga shumë qytete të tjera që janë shkatërruar, janë teatrot që ishin qendra të dëfrimit e argëtimit apo vendet e idhujve të shndërruara në gërmadha që dëshmojnë pakuptimësinë e shirkut.

Këto padrejtësi për fat të keq vazhdojnë akoma. Por nuk duhet ta harrojmë se njëra prej cilësive të Allahut Teala është “Azizun dhu intikam”. Ai është mbrojtësi i të dhunuarve dhe zbritësi i kamxhikut të dënimit hyjnor mbi zullumqarët.

Andaj qiejt nuk qanë, sytë nuk derdhën lot dhe zemrat nuk ndjenë dhimbje pas atyre që ngritën monumentet e padrejtësisë. Përkundrazi u zhdukën në koshin e mbeturinave të historisë me rënkimet dhe mallkimet e të dhunuarve.

Me të vërtetë historia është një thesar i madh plot me mësimë për njerëzimin si me faqet e saj të arta, ashtu edhe me skenat e errëta të padrejtësisë.

Dielli mbi ne është i njëjti diell që ndriçoi sarajet, pallatet dhe thesaret e njerëzve si Faraoni, Hamani, Numrudi apo të popujve si Adi e Themudi dhe që



më pas lindi me madhështi mbi gjëmadhat e tyre. Tashmë nëpër rrënojat e këtyre sarajeve madhështore dëgjohen vetëm zërat e bufave dhe të qenve...

Ndërsa ato që na kanë mbetur nga osmanët janë:

Komplekset e panumërta të shërbimit si Sulejmanije dhe Selimije. Qytetet formoheshin nga një xhami në qendër dhe kompleksi që ndërtohej rreth e rrotull saj. Aty plotësoheshin të gjitha nevojat e shoqërisë.

Çfarë kishte brenda një kompleksi?

Brenda një kompleksi gjendej **mejtëpi i të vegjëlvë** në të cilin merrnin edukim fëmijët.

Një mensesë në të cilën hanin të varfrit dhe të vobektët.

Një spital në të cilin mjekoheshin të sëmurët.

Një **çezëm** ku plotësoheshin nevojat e jetimëve dhe të varfërve.

Një **hamam** në të cilin pastroheshin njerëzit që banonin rreth e rrotull kompleksit.

Një **bibliotekë** në të cilën mësonin nxënësit e dijes...

Vendi ishte i stolisur me veprat e vakëfit ku secili prej tyre ishte një institucion dhembshurie e mëshire.



Njerëzit altruistë nëpër vakëfe përhapnin mëshirë. Shoqëria u thur me një rrjetë mëshire falë 26.600 e më shumë vakëfeve që u ndërtuan. Në shoqëri nuk u vu re asnjë kryengritje sociale, krizë ekonomike, grindje dhe gjendje depresioni.

Mëshira në atë civilizim arriti një horizont aq të lartë, saqë punonjësit e vakëfit filluan të kërkonin shërbime të vogla dhe private.

Vakëfi që ndërtoi në Sham **Bezmi Alem Valide Sulltan**, është shumë interesant. Fusha e shërbimit të vakëfit ishte sistemimi i gjërave që thyenin apo që humbitnin gabimisht shërbëtorët, në mënyrë që atyre të mos u prekej sedra.

Disa bamirës ia kishin bërë detyrë vetes përgatitjen e pajës së vajzave të varfra.

Në disa të lagje u vendosën **gurët e lëmoshës**, në mënyrë që të mos dihej ai që jepte dhe ai që merrte. Kështu shpëtoi nga cenimi i dinjitetit ai që merrte dhe u mbrojt sinqeriteti i atij që jepte.

Në disa vende të caktuara u vendosën gurët e pushimit, në mënyrë që të pushonin hamallët.

Të sëmurët mendorë nuk u quajtën “të çmendur”, por **“njerëz të nderuar me aftësi të kufizuara”**. U ndërtuan qendra në të cilat ata mjekoheshin me zërin e ujit dhe muzikë.



Po ashtu gjyshërit tanë kanë ndërtuar **hane karvanësh dhe mysafirhane**, në mënyrë që të pushonin gjatë udhëtimit ata që dilnin në udhëtim të gjatë.

Udhëtarëve që shkonin aty, u shtrohej ushqim pa i dhënë rëndësi faktit se kush ishin. Përgjatë kohës që qëndronin aty, merrnin përkujdesje edhe për kafshët dhe këto të fundit nuk liheshin të uritura. Të gjithë udhëtarët mund të qëndronin aty për tri ditë. Kur iknin, u jepeshin këpucë të reja, nëse këpucët i kishin të grisura. Përveç të tjerash, u jepeshin këshilla që të bënë kujdes përgjatë rrugës dhe përcilleshin pas namazit të mëngjesit.

Gjithashtu u ndërtuan vakëfe;

-Për t'ua paguar borxhet atyre që kishin borxhe.

-Për t'i ndihmuar gratë e veja dhe nevojtarët.

-Për t'u dhënë ndihmë fëmijëve të mejtepeve në lidhje me ushqimin dhe veshmbathjen.

-Për t'u siguruar lëndë djegëse (për ngrohje) të varfërve.

-Për t'u hequr shpenzimet e xhenazeve njerëzve të varfër dhe të vetmuar.

-Për t'i gëzuar fëmijët dhe të vetmuarit përgjatë festave.

-Për t'i mbrojtur gratë e moshuara dhe të vetmuara.



Përfundimisht gjyshërit tanë ndërtuan një vend në të cilin nuk gjendej asnjë lypës.

Ata ishin një shembull konkret që tregoi se një myslimanizëm individual është i mangët, se myslimani duhet të socializohet dhe se zemra e tij duhet të përfshijë të gjithë botën.

✿ Ajo “shoqëria e mëshirës” ekspozoi metodën e mëshirës së Islamit në arkitekturë:

Për shembull, kur shohim xhaminë Sulejmanije, shikojmë pothuajse një siluet njeriu që ka hapur duart drejt qiellit dhe po lutet. Kjo është një strukturë shpirtërore e reflektuar në gurë. Është një vepër madhështore e civilizimit tonë i cili ka ndërthurrur materien me shpirtëroren.

Gjyshërit tanë të cilët patën sjellë në ekzistencë një civilizim të virtyteve, nuk ndërtonin asnjë shtëpi që e linte në hije apo ia pengonte diellin shtëpisë së dikujt tjetër. Asnjë ndërtesë nuk i pengojë pamja. Ndërsa sot ndërtesat e larta, madje gradaçelat na sjellin në mendje gurët e varreve të qyteteve rrënojë që duken sikur u kanë hedhur përsipër dhe të vdekurve.

Në ditët e sotme, për fat të keq, çdo anë është e mbushur me ndërtesa të larta që duken si kaktuse. Çdo vend është shndërruar në grumbull betoni. Të gjithë mundohen ta shndërrojnë çdo metër katror në fitim të kësaj bote.



Ndërkohë në civilizimin e virtyteve të gjyshërve tanë, në çdo vend kishte një xhami, një çezme dhe një institucion bamirësie. Të gjithë e ndanin pasurinë e tyre me të tjerët, duke e pritur sevapin nga Allahu. Kështu që i gjithë populli përfitonte. Në këtë mënyrë qyteti jetonte i qetë dhe falte paqe.

✿ Ajo “shoqëria e mëshirës” ekspozoi metodën e mëshirës së Islamit në humanizëm, mirësjellje dhe hijeshi:

Ngaqë qendra e civilizimit tonë është “njeriu”, edhe kurora e përsosmërive të ai është tipi i njeriut të mbujtur me altruizëm, dhembshuri, mëshirë, mirësjellje dhe hijeshi që nxjerr në pah.

Për shembull, kur kishte të sëmurë në ndonjë shtëpi në këtë shoqëri të këtyre njerëzve të sjellshëm, në ballkon vendosej një lule e kuqe. Edhe shitësit e rrugës, kur e shikonin këtë, kalonin aty pa e ngritur zërin. Ndërsa fëmijët e lagjes shkonin dhe loznin nëpër lagje të tjera, në mënyrë që të mos e shqetësonin (të sëmurin).

Vepër e cilit sistem edukimi ishte kjo edukatë shpirtërore? Cili pedagog, cili psikolog dhe cili antropolog social mund ta japë këtë lloj edukate?..

Sot po shkelet e drejta e një shoqërie të tërë me fishekzjarrët që hidhen nëpër dasma dhe gëzime për argëtimin e një grupi (të caktuar) pa u marrë para-



sysh fakti se ka foshnja, gra shtatzëna, të sëmurë apo njerëz në zi që shqetësohen.

Ndërkohë gjyshërit tanë, ajo shoqëri e mirëfilltë, ishin njerëz të ndjeshëm që hezitonin të lëndonin qoftë edhe një milingonë.

❦ Ajo “shoqëria e mëshirës” ekspozoi metodën e mëshirës së Islamit në dhembshuri dhe mëshirë ndaj të gjitha krijesave për hir të Krijuesit:

U bënë shtëpi të bukura për zogj të cilat zbukuronin muret e xhamive. Pati shfaqje të panumërta mëshire ndaj maceve dhe qenve që gjendeshin nëpër rrugë dhe zogjve shtegtarë. Në këtë mënyrë njerëzit u ftuan te mëshira.

Ne kemi pasur njerëz të mëdhenj si Sinani, Karahisari dhe Fuzuli. Kemi pasur personalitete shembullore të cilat reflektonin bukurinë, estetikën, hijeshinë dhe madhështinë e botës së tyre shpirtërore ndaj kësaj bote. Kemi pasur njerëz shembullorë si Hydaji zemërbutë i cili nuk këpuste dot qoftë edhe një lule, në mënyrë që të mos e ndalonte nga dhikri. Kemi pasur njerëz të mëdhenj si Junusi i ndjeshëm i cili e vështronte me një shikim madhështor edhe një milingonë dhe që thoshte: “E duam krijesën për hir të Krijuesit.”

Si përfundim, këto përpjekje dhe sakrifica të gjyshërve tanë janë galeri mësimesh për njeriun e



sotëm. Ky umet përbëhet nga pasardhësit e njerëzve të mëdhenj si Mevlana, Junusi, Gejlani, Nakshibendi, Hydaji, Fatihu, Akshemseddini dhe Javuzi.

Civilizimi ynë ishte një civilizim virtytesh. Edhe ne duhet të posedojmë besimin, ibadetin, moralin, veprat, edukatën, personalitetin dhe karakterin që gjendeshin në themelet e atij civilizimi, në mënyrë që sot të bëhemi vazhdimësia e shoqërisë së mëshirës.

Zoti na e mundësoftë të gjithëve këtë!..





Medreseja e Anadolliit MUSA EFENDI
Sancaktepe / Staboll

Dija dhe edukimi i dobishëm

I Dërguari i Allahut (a.s.), lutej:

“O Allah! Të kërkoj mbrojtje nga dija që s’ka dobi, nga zemra që s’ka frikërespekt, nga nefsi që nuk di të ngopet dhe nga lutja që nuk pranohet.”

(Muslim, Dhikr, 73; Nesai, Istiaze, 13, 65.)

Pyetja 3

Cili janë edukimi dhe dija e vërtetë që i bëjnë dobi njeriut në këtë botë dhe botën tjetër?

Të gjitha dijet përbëhen nga zbulimi i rregullave që Allahu Teala i ka vendosur në jetë dhe gjithësi. Për shembull;

Shkenca e **mjekësisë** interesohet me rregullat madhështore që Allahu (xh.xh.), i ka vendosur në trup.

Botanika e ushtron aktivitetin e saj rreth rregullave hyjnore që u janë vendosur bimëve të cilat mbijnë nga toka.

Fizika dhe **kimia** studiojnë specifikat që Allahu Teala u ka vendosur lëndëve dhe strukturave të brendshme të objekteve.

Biologjia, matematika, jurisprudenca, sociologjia, historia, gjeografia, etj., të gjitha këto janë shkenca të kësaj bote të cilat Allahu (xh.xh.), ua ka dhuruar njerëzve.

E gjithë çështja është që të meditojmë aspektin e urtësisë së të gjitha këtyre shkencave dhe të kalojmë nga vepra për te poseduesi i veprës dhe nga arti për te artisti. Domethënë, njeriu duhet ta njohë më nga afër Allahun (xh.xh.) dhe të posedojë më shumë njohuri për ma'rifetullahun duke u nisur



nga këto shkenca ekzoterike. Kjo arrihet nëpërmjet përsosmërisë shpirtërore.

Domethënë, ka të dhëna dhe rregulla që i marrim nga jashtë, që i lexojmë nga një libër dhe që i mësojmë nga ndonjë profesor. Këto janë të dhëna ekzoterike... Këto njohuri nuk janë të mjaftueshme. Të rëndësishme janë informacionet që njeriu i jep vetes së tij. Allahu i Lartësuar thotë për të na e treguar mënyrën e arritjes së kësaj:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“...Jini të devotshëm kundrejt Allahut (bëni kujdes dhe mos e kundërshtoni Atë). Allahu ju mëson...” (Bekare, 282)

Domethënë, një dije që mësohet falë devotshmërisë... Dija ekzoterike duhet të bashkohet me dijen ezoterike dhe të formohet një harmoni ndërmjet tyre. Kjo dije e ka horizontin e hapur dhe nuk ka fund... Këtë dije na e mëson Allahu. Kjo është e lidhur me përpjekjen individuale në devotshmëri...

Detyra e tretë e pejgamberëve është “interpretimi i librit dhe urtësisë”. Me devotshmërinë fillon interpretimi i urtësisë.

Ka një ngjarje e cila është bërë shkak që Hazreti **Mahmud Sami Ramazanogllu**, i cili ishte prej miqve të Zotit, t'i drejtohej edukimit shpirtëror përgjatë viteve të rinisë:



Hazreti Sami Efendi e kreu me nota shumë të larta Fakultetin e Juridikut në Daru'l-Funun. Kur po mendonte për t'u kthyer në vendin e tij, Adana, një ditë u takua me një mik të Allahut në sheshin Bejazit. Ky mik i Zotit, pas një prezantimi të shkurtër, i tha:

“A na lejoni t’ju japim një edukim të ri?” – dhe e çoi atë te teqeja Kelami. Ndërsa po bisedonin përgjatë rrugës, ky mik i Allahut i tha Sami Efendiut:

“Bir! Edukimi ekzoterik që ke marrë, nuk është i mjaftueshëm! Po të sugjeroj edukimin e vërtetë i cili i jep njeriut lumturinë e të dy botëve:

Mësimi i parë i mejtepit të urtësisë që sapo do të fillojmë, është TË MOS LËNDOSH asnjë njeri. Ndërsa mësimi i fundit është TË MOS LËNDOHESH asnjëherë...”

Domethënë të mos prekesh nga askush në çfarëdo lloj situatë që të bëhet fjalë, duke fituar stilin e shikimit ndaj krijesave nga shikimi plot dhembshuri që Krijuesi u bën atyre. Pra, të arrish pikën kulmore në pjekurinë për të falur...

Qëllimi përfundimtar i dijes është “marifetull-llah / njohja e Allahut”. Edhe kjo nuk ka cak dhe fund... Marifetullahu është njohja e Allahut Teala në mënyrë shpirtërore dhe të bëhesh mik me Të.

Dija është gradë-gradë... Dija e njerëzve të zakonshëm. Dija e njerëzve të lartë. Dija e njerëzve



më të lartë dhe dija e pejgamberëve. Dija nuk ka fund dhe horizonti i saj është i hapur...

Tashmë dua të jap disa shembuj në lidhje me këtë:

Për shembull, Hazreti Mevlana ishte kryemësuesi i medresesë së Selçukëve. Domethënë ishte mësuesi më i lartë i të gjitha lëndëve. Ndërsa Shemsi Tebrizi ishte një dervish që e kishte zemrën të mbushur plot e përplot me përshpirtshmëri. Ai nuk ka ndonjë libër të shkruar. Po ashtu nuk posedonte dije ekzoterike sa Mevlana.

Mirë, atëherë çfarë i ka dhënë Shemsi Mevlanës? Sepse pas Shemsit Xhelaleddin Rumi u gjeti personalitetin e vërtetë dhe u bë Mevlana. Çfarë i dha ai Mevlanës? Ai ia theu atij prangat e nefsit. Pasi u thyen ato pranga, u hap një horizont madhështor. Pas hapjes së këtij horizonti doli Divani Kebir, doli Mesnevia, doli Fihi ma Fih.

Më parë nuk kanë ekzistuar këto vepra shpirtërore... Këto nuk janë vepra që vijnë me dije ekzoterike. Këto janë vepra që kanë ardhur nga horizontet e hapura pasi u thyen prangat e nefsit. Edhe sot ato nuk kanë ndonjë të ngjashme. Prej këtyre veprave është përfituar për 700 vjet me radhë. Hajt, le të dalë një universitet dhe të shkruajë sot një Mesnevi! A është e mundur?!



Çfarë specifike ka kjo dije?

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“...**Jini të devotshëm kundrejt Allahut** (bëni kujdes dhe mos e kundërshtoni Atë). **Allahu ju mëson...**” (Bekare, 282)

Kur të kemi devotshmërinë, Allahu Teala na mëson. Zoti i Madhëruar e hap horizontin sipas devotshmërisë së robit.

Kështu është edhe **Junus Emre**. Ai më parë ishte një prej dervishëve të panumërt të Anadollit. Ai nuk ka pasur ndonjë vepër apo ndonjë Divan (vepër në të cilën mbledhen poezitë e poetëve). Pasi u takua me **Tapduk Emrenë** dhe pasi kaloi nëpër disa faza duke marrë edukim shpirtëror, edhe atij iu thyen prangat e nefsit. Pastaj erdhi në pah Divani. Ai filloi të fliste me lulen e verdhë. Filloi të bëhej përkthyes i gjërave dhe i universit. Ja pra, kjo është dija e vërtetë!..

Një dije që nuk e afron njeriun ndaj Allahut, që nuk e inkurajon drejt devotshmërisë, që është e dobishme vetëm për këtë botë dhe që bëhet shkak për neglizhimin e botës tjetër, është një dije e padobishme. Për këtë arsye, kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i kërkonte dije Zotit të Madhëruar, lutej gjithmonë, duke u shprehur:



“O Zot! Kërkoj prej Teje dije të dobishme! Të kërkoj mbrojtje nga dija e padobishme!..” (Muslim, Dhikr, 73.)

Hazreti Sami Efendi shprehej në kuvendet e tij se dija e vërtetë është të ndjerët e fuqisë dhe madhësisë së Allahut Teala në zemër. Në çdo situatë ua kujtonte njerëzve nderin e arritjes së posedimit të kësaj urtësie.

Një ditë dikush që kishte shkuar për ta vizituar, kishte dashur që të merrte lutjen e Hazretit dhe t'i prezantonte me të edhe nipërit e tij. Kur kishte hyrë në audiencën e tij dhe i kishte puthur dorën, i kishte thënë duke ia prezantuar ata:

“I nderuar! Këta djelmosha kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Kërkojmë lutjen tuaj!” Ndërsa Hazreti **Sami Efendi** u kishte thënë me një buzëqeshje të rrallë.

“Edhe unë jam diplomuar në Daru'l-Funun, por **edukimi i vërtetë është mësimi i marifetull-llahut!**”⁹

Ai njeri që e mëson marifetull-llahun, bëhet mik me Allahun Teala.

Jakubi ﷺ, kishte 12 fëmijë. Botën e tij të brendshme e pa te Jusufi ﷺ. Kështu që zemra i anonte

⁹ Mustafa Erish, Kujtime nga Mahmud Sami Efendi, I, 20-21.



nga ai. Njeriu bëhet mik me atë që e ka botën e brendshme të njëjtë. Andaj, edhe Allahu i Madhëruar bëhet mik me atë që i ka larguar dëshirat vetjake nga zemra dhe ka filluar të shfaqë aty (në zemër) cilësitë e bukura.

Imam Rabbani thotë: “Ja pra, mos e lëndo atë zemër, sepse ajo zemër është fqinja e Allahut.”

Ja, kjo është dija e vërtetë...

Në ditët e sotme shohim shumë nga vëllezërit tanë të rinj, të ditur e të kulturuar që kanë mbaruar universitetin dhe kanë përfunduar studimet e larta. Por për fat të keq nuk kanë asnjë lloj informacioni nga kultura e Kuranit dhe Traditës Profetike. Për edukimin që kanë marrë pandehin se është dija që lavdërohet në Kuran dhe Sunet. Ndërkohë që dija e cila nuk e shpie mendjen dhe zemrën e njeriut te Allahu dhe që nuk bëhet shkak për perceptimin e fuqisë dhe madhësisë së tij, ndoshta në këtë botë mund t'i japë njeriut ndonjë etiketë, profesion, pozitë dhe para, por nuk mund të ketë ndonjë dobi për shpëtimin e përhershëm.

Bazuar në këto që thamë më sipër, marrja e dijës duhet të bëhet patjetër në të dyja aspektet, domethënë, njeriu e ka të domosdoshme që t'i marrë së bashku dijen dhe urtësinë.

Të mos harrojmë se dija është si një thikë me dy



tehe. Ajo mund të përdoret edhe për mirë, edhe për keq. Andaj zullumqarët që i kanë bërë padrejtësinë më të madhe njerëzimit, janë bërë prej zullumqarëve ngaqë e kanë përdorur dijen për ligësi. Faraoni, Nemrudi, Hitleri, faraonët e ditëve të sotme, etj., nuk janë njerëz që nuk posedojnë dije. Por ja që ata e kanë përdorur dijen për të bërë padrejtësi.

Për shembull, nëse një jurist nuk ka njohuri për marifetull-llahun, ai shndërrohet në një xhelat tiran. Nëse një kirurg nuk ka pjekuri shpirtërore, shndërrohet në kasap njerëzish dhe mafie organesh. Njerëzit e tillë i hedhin helm botës shpirtërore dhe e shndërrojnë në një vend ndëshkimi jetën e përhershme për një interes krejt të vogël të kësaj bote.

Hazreti Mevlana thotë:

“Njeriu i aftë dhe i ditur është i mirë, por merr mësim nga Iblisi (shejtani) dhe mos e vlerëso shumë këtë! Mos harro se Iblisi i mallkuar i cili u përzu nga mëshira e Zotit, për qindra mijëra vite ishte njëri prej më të afërmve të Allahut. Ishte prijësi i engjëjve. Ai u kaplue nga mburrja për shkak të dijes dhe ibadetit. Kështu që bëri naze dhe u ngatërrua me Ademin عليه السلام. E nënçmoi atë dhe si rrjedhojë u poshtërrua dhe iku i nënçmuar.”

Duhet të mendojmë se, një dije që e shpie njeriun drejt mburrjes e mendjemadhësisë dhe që në fund



e shtyn atë drejt shkatërrimit, edhe nëse përbëhet prej gjërave të bukura dhe të dobishme në pamjen e jashtme, në të vërtetë nuk është gjë tjetër përveçse mëkat.

Në ajetin fisnik thuhet si më poshtë për njerëzit e tillë:

عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ

“Kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë), por janë lodhur kot.”

(Gashije, 3)

Nga ana tjetër edukim i vërtetë nuk do të thotë të akumulosh dije në mendje. E rëndësishme është të shfaqim një personalitet dhe karakter në pjekurinë që kërkon dija. Në të kundërt, një dije që nuk u jep një drejtim të duhur sjelljeve, nuk është gjë tjetër përveçse një hamallëk i thatë dhe një lodhje e padobishme.

Në ajetin fisnik thuhet:

“Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat...” (Xhuma, 5)

Hazreti Sheh Sadi thotë:

“A bëhet gomari dijetar me disa libra që i ngarkohen sipër? Ai i pa tru nuk e di madje se çfarë ka në kurriz, dru apo libra.”



Për këtë arsye përsëri na jep këtë këshillë:

“Sado që të lexosh dhe saqë që të marrësh dije, prapë se prapë je injorant nëse nuk sillesh siç i ka hije dijes (domethënë nëse nuk bën një jetë me devotshmëri).”

Ajo që e shpëton njeriun nga zemra e ngurtë dhe e bën monument të mëshirës dhe dhembshurisë, ajo që e shpëton nga injoranca dhe e pajis me dijen e lumturisë së përhershme, ajo që e shpëton nga egoizmi dhe e bën altruist dhe ajo që duhet ta posedojë çdo mysliman është kultura islame.

Rezultatet e edukimit të kulturës islame i shohim në Epokën e Lumturisë:

✽ Një bari e ngriti dorën lart dhe u tha atyre që i propozuan për t’u shitur një dele pa marrë leje nga pronari: “Ku është Allahu, atëherë?!”

✽ Një torbë uji mbeti ndërmjet tre dëshmorëve në luftën e Jermukut. Këta ishin Harithi, Ikrimë dhe Ijashi (r.anhum).

Në një moment kur të gjithë kishin më së shumti nevojë për ujin, sepse po jepnin shpirt mbi rërën e shkretëtirës së nxehtë, u dhanë përparësi vëllezërve në fe dhe shfaqën virtytin e altruizmit.

✽ Një skllav mund ta ndante shpërblimin e tij ditor me një qen. Sahabi Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), këtë ngjarje e tregon si më poshtë:



Përgjatë një udhëtimi (Abdullahu) po kalonte nga një bahçe hurmash. Njeriu që i shërbente bahçes, ishte një skllav i zi. Skllavit i kishin dhënë tri bukë. Në ato momente kaloi një qen. Skllavi ia hodhi atij njërën prej bukëve. Qeni e hëngri bukën. Ia hodhi edhe tjetrën. Ai e hëngri edhe atë. Ia hodhi edhe të tretën. Ai e hëngri edhe atë.

Pas kësaj ngjarjeje ndodhi një bisedë e tillë ndër-mjet **Abdullah ibn Xhaferit**  dhe skllavit:

-Cila është pagesa jote?

-Ja, këto tri bukë që patë.

-Përse ia dhe qenit të gjitha?

-Në këto anë nuk ka qen. Andaj ky qen duhet të ketë ardhur nga larg. Zemra nuk ma pranoi që të mbeste i uritur.

-Mirë atëherë, po ti çfarë do të hash sot?

-Do të bëj durim. Të drejtën time ditore ia dhashë kësaj krijese të uritur të Zotit.

Abdullah ibn Xhaferi , u mahnit kundrejt këtij morali të lartë dhe tha:

"I lartësuar është Allahu! Njerëzit thonë se unë jam shumë bujar. Ndërkohë ky skllav paska qenë më bujar se unë!"

Pastaj e bleu atë skllav bashkë me bahçen e hur-



mave. Skllavit i dha lirinë dhe bahçen e hurmave ia dhuroi atij.¹⁰

Tani duhet të mendojmë se ky besimtar që fizikisht ishte skllav, por shpirtërisht ishte një sulltan, çfarë edukimi kishte marrë? Prej kujt dhe ku e kishte marrë? Thënë me një shprehje të ditëve të sotme: Në cilin fakultet kishte kryer doktoraturën? Produkt i cilit sistem edukimi ishte kjo pjekuri shpirtërore?..

Domethënë, çfarëdo edukimi që mund të kemi marrë në këtë botë, edukimi i vërtetë për të cilin kemi nevojë gjithmonë, është edukimi i “marifetull-llahut / njohjes së Allahut”. Domethënë njohjes së Zotit (xh.xh.), shpirtërisht...



10 Gazali, Kimjaji Saadet (Balsami i Lumturisë), Përkth. A. Faruk Mejan, Stamboll, 1977, fq. 467.





Nga e ka marrë perëndimi dijen dhe teknikën?

Nëpër veprat që janë shkruar për perëndimin në ditët e sotme me kompleksin e përçmimit (ndaj të tjerëve), nuk flitet për zbulimet, shpikjet dhe gjetjet shkencore që kanë bërë myslimanët. Gjithmonë nxirren në pah shpikjet e evropianëve. Ky mohim në të njëjtën kohë është edhe një shfaqje e mosmirënjohjes së perëndimit... Ndërkohë perëndimi ia ka borxh civilizimit Islam përparimin teknik të ditëve të sotme.

Për fat të keq myslimanët e sotëm, siç nuk i kanë dalë për zot civilizimit tonë, janë edhe të painformuar siç duhet në lidhje me të!..

Pyetja 4

Nga e ka marrë bota perëndimore dijen dhe teknikën e sotme?

Përparimin që ka arritur në ditët e sotme, perëndimi ia ka borxh pasurisë shkencore që kanë nxjerrë në pah myslimanët. Perëndimorët janë njohur me zhvillimet shkencore përgjatë kryqëzatave ose në universitetet e Andaluzisë dhe vetëm pas kësaj kanë arritur ta zhvillojnë veten.

Po ju jap disa shembuj:

- Shkenca e algjebres, zeroja dhe numrat janë gjetur prej myslimanëve dhe në Evropë kanë kaluar nëpërmjet myslimanëve.

- Gjatësia e ekuatorit është caktuar si 39 mijë kilometra me një diferencë gabimi 2.5% në fund të matjeve dhe llogaritjeve që bënë në Sinxhan dhe Kufe **Ahmed ibn Musa** dhe vëllezërit e tij në periudhën e kalifit abbasit, **Me'munit** (786-833).

Nga e merrnin dijen ata? Nga shenjat në Kuranin Fisnik...

Shumë gjeni myslimanë si,

- **Harizmi** në matematikë,
- **Xhabir ibn Hajjani** në kimi,
- **Ebu'l-Izz Ismail el-Xhezeri** në mekanikë,



- **Fergani** dhe **Battani** në Atsronomi,
- **Ibn Sina** në mjekësi, kanë bërë zbulimet më të rëndësishme të historisë së shkencës.

Për shembull:

- Ata që mundësua shndërrimin e gjeografisë në një shkencë, ishin myslimanët. Vepra *Sejahatname* e **Evlija Çelebiut** (1611-1682) i cili shëtiti në shumë shtete të botës dhe *Sejahatname* e **Ibn Battutës** (1304-1369) i cili udhëtoi pa reshtur për 29 vjet radhazi duke shkuar nga një kontinent në tjetrin, janë thesare historie dhe gjeografie.

- **Kristofor Kolombi** (1446-1506) shënon se e ka mësuar nga myslimanët, veçanërisht nga librat e **Ibn Rushdit** ekzistencën e kontinentit të Amerikës.

- **Biruni** (973-1048) para shumë shekujsh ka folur për ekzistencën e Amerikës.

- **Piri Reis** (1465-1554) në veprën e tij me titull *Kitabi Bahrije* ka vizatuar hartën e Evropës. Përveç të tjerash harta e botës që ka bërë Piri Reisi është një prej gjërave që edhe sot nuk e zgjidh dot shkenca e historisë. Në këtë hartë “Ishulli i Gruenlandës” jepet në tri pjesë në përputhje me gjendjen origjinale. Ndërkohë kjo është një e vërtetë e zbuluar vetëm pasi njeriu ka shkelur në hënë.

- **Idrisi** (1100-1166) rreth 800 vjet më parë ka



arritur të bëjë harta të ngjashme me hartat e botës së kohës sonë.

- Nuk duhet të harrojmë se;

Kristof Kolombi, Macellani, Amerigo Vespucci, etj., shfaqen si zbulues perëndimorë. Ndërkohë këta nuk janë zbulues. Shumica e tyre kanë qenë njerëz banditë. Me të vërtetë këta kanë qenë hajdutë, banditë dhe kriminelë që mbartnin skllevër me anije nga Afrika, i hidhnin nga anija në mes të oqeanit ata që bënë rezistencë dhe që kolonizuan, skllavëruan dhe vranë njerëzit autoktonë të Amerikës për vite me radhë.

Ndërsa personalitetet myslimane si **Ibn Battuta**, Evlija Çelebiu dhe të tjerë si ata e kanë njoftuar botën në formën më efikase për çdo vend ku kanë shkuar.

- Në një lëmi tjetër shkencore **Ibn Halduni** (1332-1406) i cili ishte prej figurave më të zgjedhura të filozofisë historike, njihet si themeluesi i shkencës së sociologjisë. Ai edhe në ditët e sotme e ndriçon botën e shkencës me veprën e tij Mukaddime.

- Ndërsa kur flitet për arkitekturën, i pari që vjen në mendje në rang botëror është **Arkitekt Sinani** (1489-1588) i cili akoma jeton në zemrat tona me veprat e tij madhështore. Madje sot konsiderohet arkitekt i madh një njeri që mund ta imitojë Sinanin.



• Observatorët që ndërtuan **Ulug Beu e Ali Kushçu** dhe hartat e qiellit që bënë ata në astronomi, janë vepra që prijnë në historinë e shkencës.

Nëpër veprat që janë shkruar për perëndimin në ditët e sotme me kompleksin e përçmimit (ndaj të tjerëve), nuk flitet për zbulimet, shpikjet dhe gjetjet shkencore që kanë bërë myslimanët. Gjithmonë nxirren në pah shpikjet e evropianëve. Ky mohim në të njëjtën kohë është edhe një shfaqje e mosmirënjohjes së perëndimit... Ndërkohë perëndimi ia ka borxh civilizimit Islam përparimin teknik të ditëve të sotme.

Profesor **Fuat Sezgini**, i cili ka ndërruar jetë në një kohë të afërt, ishte një dijetar që ia kishte dedikuar jetën e tij vërtetimit të këtij fakti. Ai me punimet që bëri, tregoi se;

Në ditët e sotme me një qasje në qendër Evropën, përdorimi për herë të parë i matematikës në shkencat natyrore i atribuohet **Roger Baconit** (1219-1292), ndërsa shpikja e “dhomës së errët” e cila është baza e shkencës optike dhe e aparatit fotografik i atribuohet **Levi ben Gersonit** (1288-1344). Ndërkohë për të dyja përparësia i përket **Ibn Hejthemit** (v. 1041).

Ndërtimi i trigonometrisë si një shkencë më vete i atribuohet **Regiomontanusit** (v. 1476). Ndërkohë kjo i përket **Nasiruddin Tusit** (v. 1274).



Përshkrimi i botës me në qendër diellin së pari u atribuohet **Kopernikut** dhe **Keplerit**. Ndërkohë këta dijetarë kanë qenë të ndikuar nga dijetarët si **ez-Zerkali** (shekulli i 11-të) nga Andaluzia. Në çdo fushë mund të jap me qindra shembuj.¹¹

Tashmë dëshiroj të jap një shembull në lidhje me fanatizmin e perëndimit kundrejt të vërtetave shkencore që nga shekulli i 16-të.

Falë veprave që u përkthyen nga dijetarët myslimanë në Evropë, filluan të përhapeshin të vërtetat në lidhje me astronominë. **Galileo**, sikundër asaj që pohonte kisha, tha se Toka rrotullohej. Për këtë arsye u dërgua në gjykatën e inkuizicionit. Ai u dënua me burgim të përjetshëm. Galileo e ndryshoi deklaratën e tij për të shpëtuar nga ndëshkimi, por kur po dilte nga dera nuk e mbajti dot veten dhe tha përsëri:

“Edhe pse unë them nuk rrotullohet, Toka rrotullohet!”


Ja edhe një shembull tjetër: Kur mendimtarët e rëndësishëm të Evropës si **Thomas Aquinasi**, **Pascali**, **Descartesi** dhe **David Hume** po formonin sistemet e mendimit, përfituan prej veprave të Imam Gazaliut.

11 Shih. Fuad Sezgin, Shkenca dhe Teknika në Islam, 2008, vëll. I, fq. 163-166.



Për fat të keq myslimanët e sotëm, siç nuk i kanë dalë për zot civilizimit tonë, janë edhe të painformuar siç duhet në lidhje me të!..





Shfrytëzimi i grave me maskën e barazisë

Gratë në injorancën moderne të ditëve të sotme po inkurajohen për ta treguar veten dhe për t'u ekspozuar në botën e jashtme, duke u ftohur nga familja, shtëpia dhe amësia. Pothuajse një lule e rrallë po shkelet me këmbë.

Sa gjendje e dhimbshme dhe trishtuese është që një diamant i paçmueshëm të shndërrohet në një mbeturinë!..

Pyetja 5

Vitet e fundit dolën në pah çështje si “Puni-met e Grave” në fillim dhe menjëherë pas saj “Gjinia Shoqërore”. Për fat të keq po punohet që struktura e familjes myslimane ta humbë ndikimin e saj nën emrin “Barazia Gjinore”. Me cilin vetëdijesim duhet të edukohen djemtë dhe vajzat në emër për t’u ruajtur nga këto lloj devijimesh?

Së pari duhet të shprehim këtë: Të qenët femër apo mashkull nuk është shkak më vete për ndonjë epërsi apo mangësi. Epërsia në Islam është vetëm në “devotshmëri”. Allahu i Lartësuar thotë:

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (Huxhurat, 13)

Ndryshimi ndërmjet femrës dhe mashkullit është në jetën fizike. Ndërsa në jetën shpirtërore nuk ka asnjë ndryshim. Masa e vetme e vlerës te Allahu për femrat dhe meshkujt, qofshin të bardhë apo të zinj, është “devotshmëria”. Edhe femrën, edhe mashkullin i ka krijuar Allahu. Që të dyve u ka dhënë specifika të ndryshme.

Në ditët e sotme për fat të keq jemi ballë për ballë me një degradim ndryshe i cili quhet “barazia femër-mashkull” dhe që është një demonstrim i devijimit të kësaj kohe.



Allahu i Lartësuar e ka krijuar të ndryshme natyrën e mashkullit nga natyra e femrës. Të qenët femër dhe të qenët mashkull janë dy cilësi të ndryshme që e plotësojnë njëra-tjetrën. Barazia femër-mashkull në një farë mënyre është si t'i shohësh njëllot mollën dhe dardhën apo t'i konsiderosh njëllot pulën dhe gjelin. Ndërkohë, a mund ta kryejë një pulë funksionin e një gjeli? Apo, a mund të kryejë një gjel funksionin e pulës?! A mund të këndojë pula si gjeli?..

Barazia ndërmjet femrës dhe mashkullit është gjë tjetër, drejtësia është gjë tjetër. Edhe llafet për barazi mund të tingëllojnë bukur në vesh, por jo vetëm që nuk kanë të bëjnë me drejtësinë, por janë një zullum dhe padrejtësi që i dëmton të dyja palët.

Nuk duhet të harrojmë se Zoti (xh.xh.), e ka mbrujtur botën shpirtërore të femrave me **mëshirë** dhe **dhembshuri**. Detyra parësore e tyre është që të rrisin e edukojnë fëmijët të cilët janë themeli i së ardhmes.

Në ajetin fisnik thuhet:

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ
وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“...O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe



trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!" (Furkan, 74)

Gruaja duhet të bëhet një "njeri i mëshirës" dhe duhet të edukojë një "brez të mëshirës". Ajo duhet të edukojë një brez që është prehje për sytë tanë. Ky brez duhet të bëhet prijës në devotshmëri për shoqërinë. Allahu i Lartësuar kërkon prej nesh një shoqëri të tillë.

Klasa e parë ku marrin mësim fëmijët, është zemra e nënës. Andaj thuhet: **الْأُمُّ مَدْرَسَةٌ / Nëna është një shkollë."**

Xhevahiri i virtytit që i shkrim zemërimet e individëve në vatrën familjare dhe veçanërisht acarimet e bezdisshme të fëmijëve është vetëm zemra e nënës. Një baba nuk mund të bëjë durim kundrejt fëmijës siç bën një nënë.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, ngaqë babai është më i fuqishëm, i ka dhënë atij detyrën për të siguruar jetesën e familjes në botën e jashtme. Domethënë se Zoti (xh.sh.), i ka caktuar detyrat në përputhje me natyrën e njeriut.

Andaj, hedhja e gruas në vështirësitë e botës së jashtme e cila është e tej mbushur me rreziqe, për të fituar jetesën duke e shkëputur nga mirëmbajtja e shtëpisë dhe përkujdesja ndaj fëmijëve, është padrejtësi për gruan. Fakti që gratë fitojnë disa qindarka



më shumë, ndërkohë që humbin virtytet dhe shpirtin e tyre të brishtë që është një thesar i paçmueshëm, nuk mjafton për ta kamufluar këtë padrejtësi.

Shkëputja e gruas nga detyra e saj kryesore që është edukimi i fëmijëve, shkëputja e saj nga ushtrimi i detyrës së nënës, shndërrimi i saj në një artikull vitrine dhe orientimi i saj drejt botës së jashtme, e ka çuar familjen në rënie. Divorcet po shtohen. Brezat po shkatërrohen. Martesat po pakësohen, sepse martesa po perceptohet si një barrë e rëndë.

Gratë **në injorancën moderne** të ditëve të sotme po inkurajohen ta tregojnë veten dhe për ta ekspozojnë në botën e jashtme duke u ftohur kështu nga familja, shtëpia dhe amësia. Pothuajse një lule e rrallë po shkelet nën këmbë. Sa gjendje e dhimbshme dhe e trishtueshme është që një diamant i paçmueshëm të shndërrohet në një mbeturinë!..

Bota perëndimore në sistemet e saj prishura thotë se po përpiqet të luftojë me traditat që e poshtërojnë femrën nën moton “barazia gjinore në shoqëri”. Ndërkohë në këtë mënyrë po ia ulin vlerën gruas edhe më shumë.

Nëse femrave u jepet formë duke mos u marrë parasysh natyra e tyre, atëherë kjo nuk u shton atyre asnjë vlerë. Siç mund t’ia bëjë jetën burg njeriut një maskë e zbukuruar që vendoset në fytyrë dhe që e pengon shikimin ngaqë sytë nuk janë marrë në konsideratë, e tillë është edhe kjo çështje.



Femra në Evropë është shtyrë drejt rrugëve, fabrikave dhe vitrinave, duke u mashtruar nga kauza e barazisë me mashkullin. Ajo është shndërruar në një manekinë epshi.

Ndërkohë nderi është një cilësi që i përket vetëm njeriut. Ndërsa mosruajtja e nderit është largim nga dinjiteti njerëzor. Pra, është një jetë pa përgjegjësi, e ulët dhe e dobët si ajo e kafshëve.

Femra e cila deri dje në perëndim nuk merrej në konsideratë për njeri dhe që konsiderohej si shejtan (djall), tani perceptohet si një fuqi pune, si mall tregtie ose si një artikull marketingu.

Për shkak të ligjit të “tërheqjes” natyrale ndërmjet mashkullit dhe femrës, është shfrytëzuar pasioni i mashkullit ndaj femrës. Mënyra për të marrë vlerë duke ekspozuar bukurinë dhe duke përdorur të qenët femër u është injektuar grave si liri.

Mendimtari i madh i Bosnjës, **Alija Izzet Begoviçi** thotë:

“Përse u bëjnë padrejtësi femrave që mbulohen për hir të Allahut dhe përse i përçmojnë femrat që nuk e ekspozojnë veten për shkak të devotshmërisë ata që e duartrokasën femrën që zhvishet gjoja për art?!”

Bukuria e femrës në Islam është kodimi me mbulesën në botën e jashtme dhe ekspozimi vetëm



ndaj bashkëshortit. Në këtë mënyrë, kur femra del në botën e jashtme, ekziston jo me seksualitetin, por me personalitetin e saj.

Femra e cila është futur në rivalitet me meshkujt në jetën sociale këto ditët e sotme ndërkohë që të qenët grua, nënë dhe zonjë e vatrës së saj është cilësia më e lartë, po largohet gradualisht nga familja dhe po shndërrohet në një armike të amësisë.

Disa femra që janë rritur duke u edukuar në mënyrë egoiste dhe individualiste, lindjen e fëmijës nuk e shohin të përshtatshme për dëshirat e tyre vetjake dhe e konsiderojnë (lindjen) shkak për prishjen e strukturës së trupit. Në këtë mënyrë u përhap në masë kasapllëku i abortit.

Ndërsa Allahu i Lartësuar, duke na njoftuar për një panoramë nga gjykimi i madh në ditën e kiametit, thotë:

“Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrarë!” (Tekvir, 8-9) Edhe kasapët e abortit në ditët e sotme i pret një llogari shumë e vështirë dhe një ndëshkim i tmerrshëm prej këtij kërcënimi hyjnor.

Femrat e privuara nga ndërgjegjja që nuk e duan foshnjën e tyre vetëm për shkak të dëshirave vetjake dhe e dorëzojnë atë të kasapi i abortit duke mos pasur asnjë arsye të pranueshme, duhet t'i pyesim:



“Me çfarë të drejte e merr një jetë që e ka dhënë Allahu! Pastaj, a e di ti gajbin?! A e di se çfarë do të sjellë e ardhmja?! Fëmija që i more jetën, ndoshta nesër do të bëhej një strehim, mbrojtje dhe mbështetje për ty. Ai do të të dilte për zot dhe do të të mbronte kur të mbesje vetëm dhe të kishe nevojë për përkujdesje...”

Sa kontradiktë interesante është fakti se, ata të cilët e quajnë “vrasje masive e kafshëve” Kurban Bajramin i cili bëhet shkak për të hyrë mish qoftë edhe një herë në vit në shtëpitë e të varfërve dhe fukarenjve, nuk nxjerrin zë për “vrasjen masive të fëmijëve” në barkun e nënës!

Në botën e këtyre njerëzve që u është tharë ndërgjegjja, në vend të fëmijëve, është përhapur mbajtja e qenve pikërisht si në kohën e injorancës.

Bazuar në transmetimin që vjen nga Katade, shkaku pse fiset arabe në kohën e injorancës i vrisnin fëmijët vajza duke i groposur të gjalla ishte:

“Frika prej varfërisë dhe marrja nëpërkëmbë e nderit të vajzave nëse do të liheshin gjallë dhe do të kapeshin si robëresha.”

Transmetohet se ata i vrisnin vajzat që në moshë të vogël për të mos rënë në këtë gjendje dhe në vend të tyre mbanin qen. (Taberi, Tefsir, VIII, 68; En'am, 140.)



Trajtimi i krijesave me dhembshuri dhe ushqyerja e tyre sigurisht që është një veprim i mirë, por vendosja e qenve në vend të fëmijëve dhe ushqyerja e qenve në vend të tyre, sigurisht se është shqetësues nga aspekti i familjes dhe shoqërisë.

Po ashtu në injorancën moderne kërkohet që femrat ta shohin martesën si një barrë. Njerëzit janë inkurajuar që të divorcohen, të mos martohen dhe të jetojnë të ndarë e të vetëm. Në vend të martesës është shtuar interesi për flirtin.

Në këtë mënyrë i është hedhur helm jetës familjare. Fëmijët e jashtëligjshëm dhe fëmijët që u janë divorcuar prindërit e kanë mbetur të vetmuar, janë shndërruar në një çështje serioze në shoqëri.

Pasi mori plagë jeta familjare dhe pasi u trondit mirësjellja, edukata dhe dashuria ndërmjet mashkullit e femrës, në një pjesë të shoqërisë u shfaq belaja e “homoseksualizmit”. Ky veprim i ulët që nuk gjendet as te kafshët dhe që ka filluar me popullin e Lutit, i cili për këtë arsye u fundos në fund të dheut, është lançuar si “e drejtë njerëzore” nga perëndimi. Kjo poshtërsi që nuk përputhet me njerëzimin, ka formuar një fushë të saj nëpër shoqëri.

Pasi në perëndim femra u shtyp në botën e jashtme në të cilën u nxor duke u mashtruar, këtë herë lindi kauza e **“feminizmit”** dhe e **“të drejtave të grave”**. Gjoja për t’i ngushëlluar ato, 8 marsi u



shpall si Dita Ndërkombëtare e Grave në kujtim të punëtoreve që vdiqën prej zjarrit që ra në një fabrikë. Ndërsa tani kjo ditë në të gjithë botën konsiderohet si dita në të cilën kujtohen të drejtat e grave.

Por ja që, ato që thuhen, ato që shprehen, ankesat dhe gjërat që nxirren në pah gjoja si zgjidhje, janë shumë larg nga të qenët zgjidhje për hallet dhe shërim për zemrat, sepse janë larg natyrshmërisë njerëzore! Sepse janë në kundërshtim me qëllimin e krijimit të femrës!..

Diploma e perëndimit në lidhje me gratë e djeshme dhe të sotme është plot e përplot me nota të dobëta. Ata që e kanë diplomën në këtë gjendje, marrin guximin të diskutojnë (pozitën) e gruas në Islam.

Perëndimi, në të cilin ka rënë familja dhe shoqëria, po përpiqet t'ua imponojë edhe shoqërive të tjera perceptimin e vet që ka ndaj jetës.

Të mos harrojmë se, një shoqëri që posedon strukturën familjare më të shëndetshme në botë, nuk mund të ketë asgjë për të mësuar nga perëndimi i cili gjendet në prapësinë e falimentimit në lidhje me këtë çështje. (Përndryshe) ky do të ishte një mashtrim dhe budallallëk i trishtueshëm që i ngjan gjendjes së një të shëndetshmi i cili dëshiron të sëmuret.

Atëherë le të mos bëhemi prej të mjerëve që



nuk kanë informacion për kimetin e vlerave të tyre themelore dhe që pothuajse vdesin të uritur mbi thesar. Le të jemi të zgjuar kundrejt këtyre projekteve djallëzore. Ndërkohë, le t'i informojmë edhe njerëzit tanë.

Edhe këtë le ta perceptojmë mirë se, të gjitha sistemet njerëzore që pohojnë se e kanë lartësuar femrën, nuk kanë bërë asgjë tjetër veçse e kanë poshtëruar atë, sepse, qëllimet e helmuara të tyre që në aparence duken si “mbrojtje e femrës”, në planin e pasmë janë të mbushur plot me çdo lloj shfrytëzimi dhe britma të dhimbshme.

Ato që po ndodhin sot nën emrin e barazisë për femrat, në fund shndërrohen në padrejtësi të tjera dhe bien përsëri mbi kokën e femrave.

Edhe pse është quajtur barazi, ky kurth që e prish ekuilibrin e shenjtë në familje, pavarësisht se duket shumë i pafajshëm, për shkak të tij janë shkatërruar shumë vatra dhe breza. Domethënë është shkatërruar njerëzimi.

Qëndrimi i sinqertë dhe suksesi i vetëm në lidhje me këtë çështje i përket vetëm Islamit.

Islami e ka ngritur nga vendi ku kishte rënë femrën e cila shtypej, nëpërkëmbej dhe varrosej e gjallë në periudhën e injorancës dhe e ka lartësuar në pozitën fisnike që i ka caktuar Allahu i Madhëruar.



Faqet plot dhimbje të historisë janë në pah: Njerëzit e xhahiljetit dhe fetë e shtrembëruara si krishterimi e kanë konsideruar femrën si djall. Ata e kanë konsideruar femrën një qenie më e ulët se mashkulli.

Ndërsa Islami i ka dhënë femrës një pozitë shumë të lartë. Ai ka deklaruar se xheneti gjendet jo nën këmbët të baballarëve, por të nënave.

Pas të gjitha fitoreve të mëdha gjenden gjithmonë nënat sakrifikuese. Për shembull, nëse shohim fitoren e Çanakalesë, do të vëmë re se kjo (fitore) ishte edhe e nënave sakrifikuese që i lypnin fëmijët e tyre me këna dhe i dërgonin në front, sepse këta ushtarë trima ekzistonin falë atyre nënave sakrifikuese.

Islami e ka lartësuar femrën si sulltani i familjes dhe një zonjë që e mban në këmbë vatrën e saj. Një nënë që e mbart fëmijën nëntë muaj në bark, më pas në krahët e saj plot butësi dhe pastaj në zemër përgjatë gjithë jetës, meriton të falënderohet përgjithmonë.

Islami nuk e lejon dhunën jo vetëm ndaj njeriut dhe femrës, por ndaj asnjë krijese. Ai nuk lejon që të ushtrohet dhunë ndaj kafshëve. Po ashtu nuk pranon që edhe një degë peme të shkundët me ashpërsi. Islami është feja e dhembshurisë, mëshirës, mirësjelljes dhe hijeshisë. Për këtë arsye, dhuna



ndaj femrës nuk mund të gjendet në asnjë vend ku Islami zbatohet në mënyrë të drejtë.

Femrën e ka lartësuar Allahu (xh.xh.). **I Dërguari i Allahut** ﷺ, e ka lartësuar femrën. Në hadithin fisnik thotë: *“Tri gjëra më janë bërë të dashura nga kjo botë.” Ai që ia ka bërë të dashura është Allahu Teala. Njëra prej këtyre shprehet se është “gruaja e devotshme”.¹²*

Ebu Hurejre (r.a.), tregon:

“Një person erdhi te Resulullahu ﷺ dhe e pyeti:

“Kush është ai ndaj të cilit duhet të sillem më mirë?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

«Nëna!» Sahabi pyeti përsëri:

«Po pas saj kush është?» I Nderuari ynë përsëri i tha:

«Nëna!» Sahabi e pyeti përsëri:

«Po pas saj kush vjen?» I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

«Nëna!» Sahabi përsëri e pyeti:

«Pastaj kush vjen?» Resulullahu ﷺ, këtë herë i dha këtë përgjigje:

«Babai!» (Buhari, Edeb, 2; Muslim, Birr, 1.)

Ata që dëshirojnë ta shohin nderin që Islami i ka dhënë femrës, duhet të shohin vlerën që i është dhënë nënës sonë, **Merjemes** në Kuranin Fisnik. Duhet të shohin vlerën që i ka dhënë Pejgamberi ynë i nderuar **Hazreti Hatixhes**. Edhe pse Resullallahu (s.a.s.), përjetoi vite të mbushura plot me shumë vuajtje dhe dhimbje, vetëm viti në të cilin ka ndërruar jetë nëna jonë, Hatixhja është quajtur “viti i pikëllimit”.


Sikundër kësaj, **i Nderuari ynë** ﷺ, na ka njoftuar në formën e paralajmërimit se natën e Miraxhit është ndaluar dhe ka parë te dera e xhehenemit dhe se ata që do të hynin më së shumti aty do të ishin gratë¹³, sepse gratë janë të mbushura me një ndjesi të madhe. Nëse këtë ndjeshmëri e përdorin për mirësi në rrugë të Allahut, meritojnë një falënderim të përjetshëm. Por, nëse i përdorin këto aftësi për dëshirat vetjake, Allahu na ruajt, atëherë janë të predispozura të shtypen nën këmbë si lulet që çelin buzë kalldrëmeve. Si rrjedhojë shndërrohen në një objekt që përdoret dhe pastaj flaket tutje.

Si përfundim, kur femra jeton në kushte të përshatshme me veçoritë e krijimit të saj, shoqërinë e kaplon prehja e xhenetit. Përgjatë gjithë historisë shoqëritë kanë përparuar me gra të devotshme dhe po ashtu janë shkatërruar me gra të devijuara, sepse

13 Shik. Buhari, Rikak, 51; Muslim, Zuhd, 93.

femra me rolin e saj të veçantë në institucionin e familjes që formon bërthamën e shoqërisë, është si një llambadar kristali i shoqërisë. Nëse femrës i tregohen rrugët për lumturi, atëherë ky llambadar kristali bie nga pozita e lartë që e meriton dhe rrugët e jetës mbushen me copa qelqi...





Shtylla e fesë Namazi

Dëshira e zjarrtë ndaj namazit është një shfaqje e dashurisë në zemër ndaj Allahut (xh.xh.). Ai që e do Allahun, edhe urdhrin e Tij e zbaton me dashuri, sepse namazi është një takim dhe bisedë me Allahun e Lartësuar.

Le të përpiqemi të bëjmë vepra që i do Allahu, në mënyrë që edhe Allahu të na dojë, sepse, kur Allahu e do robin e Tij, i dhuron edhe dashurinë për të kryer veprat që Ai i do. Pra, ia mundëson atij t'i kryejë ato duke ndjerë një kënaqësi të papërshkrueshme.

Pyetja 6

Si mund ta bëjmë namazin më shumë pjesë të jetës sonë? Çfarë mund të thoni në lidhje me rëndësinë e namazit?

Së pari duhet të shohim ndjeshmërinë që kishte Resulullahu ﷺ, ndaj namazit. I Nderuari ynë ﷺ, ka thënë:

“Nuk ka mirësi në një fe na ruku (pa namaz).”

(Ebu Davud, Haraxh, 25-26.)

Gjithashtu në një hadith tjetër fisnik jemi lajmëruar se pyetja e parë që do të bëhet në lidhje me ibadetet në ditën e gjykimit, do të jetë për “namazin” dhe se robi do të shpëtojë nëse i ka falur namazet në atë formë që Allahu është i kënaqur dhe se do të humbë nëse ka ndodhur e kundërta.

Po ashtu i Nderuari ynë ﷺ, kur po jepte frymën e fundit, ka thënë tri herë: *“Kini frikë prej Allahut në lidhje me çështjen e namazit!”* Pastaj ia dorëzoi Zotit (xh.xh.), shpirtin e tij fisnik duke u shprehur përsëri: *“Namazi, namazi!..”*, pasi dha edhe disa këshilla të tjera.

✽ Kur Omeri ؓ, u plagos rëndë nga atentati që i ndodhi, i binte të fikët nga hemorragjia dhe nuk mund të vinte dot në vete në asnjë mënyrë. Por kur hynte koha e namazit dhe dikush i përkulej te veshi e i thoshte:



“Namazi o Omer, namazi!”, vinte në vete me një vullnet mahnitës dhe me atë gjendje e falte namazin. Pastaj thoshte:

“Ai që s’ka namaz, s’ka vend në Islam!” – dhe e humbte përsëri vetëdijen.

✽ Tregon **Rebia ibn Ka’bi** (Ebu Firasi), ﷺ i cili e kalonte natën te dera e të Dërguarit të Allahut ﷺ, që i përgatiste atij ujin e abdestit dhe që i sillte gjërat për të cilat kishte nevojë :

Një ditë Resulullahu ﷺ, më tha:

“Kërko prej meje, që të të jap.” Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Më jepni kohë që të mendohem dhe ta shoh gjendjen time.” I Nderuari ynë ﷺ, më tha:

“Në rregull, mendo dhe shihe gjendjen.”

Mendova dhe me vete thashë:

“Interesat që i përkasin kësaj bote harxhohen dhe mbarojnë shpejt. Nuk shoh gjë më të mirë për veten time, sesa të zgjedh diçka të dobishme në lidhje me ahiretin.” Pastaj shkova në audiencën fisnike të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai me tha:

“Çfarë nevoje ke?” Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Ndërmjetëso për mua, në mënyrë që Zoti (xh.xh.), të më lirojë nga xehenemi!” Resulullahu ﷺ, më tha:

“Kush të mësoi që ta thuash këtë?” Unë i thashë:

“Pasha Allahun, o i Dërguari i Allahut, askush nuk më mësoi. Por pashë gjendjen time dhe vura re se kjo botë nuk qëndron në duart e atyre që e duan. Ajo zhduket menjëherë. Për këtë arsye preferova të kërkoja diçka për ahiretin.”

Resulullahu ﷺ, më tha:

“Atëherë më ndihmo për veten tënde duke bërë shumë sexhde!” (Ahmed, IV, 59; Shik. Muslim, Salat, 226.)



Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik flet për **“namazin”** në 99 vende, duke u bazuar në rëndësinë e tij.

Allahu Teala është Ai që na fton për të falur namazin duke thënë: **“...Bëj sexhde dhe afrohu.”** (Alak, 19)

Për këtë arsye, dëshira e zjarrtë ndaj namazit është një shfaqje e dashurisë në zemër ndaj Allahut (xh.xh.). Ai që e do Allahun, e zbaton edhe urdhrin e Tij me dashuri, sepse namazi është një takim dhe bisedë me Allahun e Lartësuar.

Le të përpiqemi të bëjmë vepra që i do Allahu, në mënyrë që edhe Allahu të na dojë, sepse, kur



Allahu e do robin e Tij, i dhuron edhe dashurinë për të kryer veprat që Ai i do. Pra, ia mundëson atij t'i kryejë ato duke ndjerë një kënaqësi të papërshkrueshme.

Meqë ra fjala, këtu dëshiroj të transmetoj një kujtim:

Një ditë më erdhi pranë një nxënës afrikan dhe më tha:

“Hoxhë, lutuni për mua!” I thashë:

“Bir, çfarë dëshiron? Për cilin problem kërkon lutje?”

Ia bëra këtë pyetje, sepse prej të rinjve në shumicën e rasteve më vinin kërkesa për lutje në lidhje me çështjet si kalimi me sukses i ndonjë provimi, përfundimi i universitetit, gjetja e ndonjë pune ose çështja e martesës. Ndërsa kërkesa për lutje e atij të riu ishte shumë e rrallë. Ai më tha:

“Hoxhë! Lutjuni Allahut që të ma bëjë namazin shumë të dashur!”

Me të vërtetë dashuria ndaj namazit duhet të jetë një ideal i rëndësishëm për çdo besimtar.

Ky ishte edhe i gjithë halli i **Hazreti Ibrahim** عليه السلام. Edhe ai i lutej kështu Zotit (xh.sh.):

“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi ta kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!” (Ibrahim, 40)



Domethënë se, të qenët vetë dhe pasardhësit prej atyre që e falin namazin me devotshmëri, ka qenë një njëra prej çështjeve që i preokuponte më së shumti edhe vetë pejgamberët. Përgjërimi ndaj Allahut, në mënyrë që ta na e mbushë zemrën me dashuri për namazin, është një domosdoshmëri e besimit të vërtetë.

Nëse një prind i do fëmijët e tij, nëse është i mëshirshëm ndaj tyre, atëherë duhet t'i ushtrojë ata me namazin që në moshë të vogël.

Allahu na ruajt, sepse është shumë e dhimbshme, kur njeriut i vdes më i afërmi, ai mërzhitet shumë për atë ndarje. Pastaj me kalimin e kohës i pakësohet mërzhitja. Por pikëllimi i ndarjes më të madhe do të përjetohet në ditën e gjykimit. Robërve të devotshëm që janë prej banorëve të xhenetit, do t'u thuhet me një nderim dhe lavdërim të madh: "Urdhëroni në xhenet!", bazuar në ajetin fisnik në të cilin thuhet:

سَلَامٌ قَوْلًا مِنْ رَبِّ رَحِيمٍ

"Paqe!" - do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë." (Jasin, 58)

Por sikundër kësaj, mëkatarëve që janë banorë të xhehenemit, do t'u thuhet:



وَأَمَّا زُورَ الْيَوْمِ أَتْيَهَا الْمُجْرِمُونَ

“(Ndërsa keqbërësve Ai do t’u thotë): **“Veçohuni sot ju, o kriminelë!”** (Jasin, 59) Ndoshta atje do të ndahen nga njëri-tjetri shumë bashkëshortë e bashkëshorte. Shumë fëmijë dhe prindër do të shkojnë në rrugë të ndryshme. Një pjesë e të afërmeve që kanë jetuar bashkë në këtë botë, do të shkojnë në një anë dhe një pjesë do të shkojnë në anën tjetër. Ajo do të jetë një ditë në të cilën do të përjetohet një pikëllim i jashtëzakonshëm!..

Ja pra, për të mos u bërë prej të pikëlluarve atë ditë, sot duhet të kemi kujdes për orientimin tonë dhe t’i pranojmë fëmijët, të cilët janë zemra jonë, si amanet i Allahut Teala e të preokupohemi me edukimin shpirtëror të tyre që në moshë të vogël.

Imam Maliku (r.a.), thotë:

“Kur mësoja një hadith, babai më jepte një dhuratë. Erdhi një kohë e tillë që, edhe nëse nuk më jepte dhurata babai, mësimi i hadithit u shndërrua në një kënaqësi për mua.”

Ja pra, edhe ne kështu duhet t’i inkurajojmë fëmijët tanë për namazin. Duhet t’i marrim përdore dhe t’i çojmë në xhami. Duhet t’ua bëjmë të dashur namazin dhe t’i ushtrojmë me të duke u dhënë shpërblime, në mënyrë që edhe pas nesh të vazhdojnë ta falin namazin duke marrë kënaqësi,



shije dhe përshpirtshmëri prej tij. Në lidhje me këtë çështje edhe ne duhet t'i lutemi Zotit siç iu lut Ibrahim (a.s.), në mënyrë që fëmijët tanë të bëhen prej atyre që e falin namazin, inshallah.

✽ Allahu i Lartësuar i ka dhënë aq shumë rëndësi namazit, saqë ka thënë:

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur (përshtatshëm) kudo dhe kurdo që të faleni!..” (A'raf, 31) Domethënë se në namaz duhet të jemi të vetëdijshëm se gjendemi në audiencën hyjnore. Andaj nuk duhet ta falim namazin me rroba të papërshtatshme dhe të papastra. Namazin duhet ta falim duke qenë të rregullt (në veshje).

Që kur isha i vogël, i shihja me kujdes të mëdhenjtë tanë që tashmë kanë kaluar në mëshirën e Zotit. Kur kishin për të falur namazin, ata i rregullonin edhe fijet anash sixhadesë nëse ishin të çrregullta dhe më pas fillonin faljen.

Ja pra, çfarë ndodh për shkak të këtij përkushtimi që shfaqet ndaj namazit? Namazi e mbron njeriun nga shthurja dhe çdo vepër e shëmtuar.¹⁴

Njeriu në këtë mënyrë mund ta kuptojë gradën e pranimit të namazit:

Ai namaz që fal;

14 Ankebût, 45.



-A ia mbron sytë që të mos shikojnë haram?

-A ia mbron veshët që të mos dëgjojnë zëra dhe fjalë të gabuara?

-A ia mbron gjuhën nga përgojimi, thashethemet, gënjeshtra, shpifja dhe bisedat boshe?

-A ndjen hushu (frikërespekt ndaj Zotit) përgjatë namazit?

-A i mbushet zemra me përshpirtshmëri pasi e fal namazin?

Ja pra, një namaz i pranuar e mbron njeriun nga shthurja dhe çdo vepër e shëmtuar. Ai ia mbush njeriut botën e brendshme me frymëzimin dhe përshpirtshmërinë e afrimit me Zotin (xh.xh.). Çdo njeri mund ta vërtetojë gradën e pranimi të namazit që ka falur, duke parë se sa i posedon ai këto gjendje.

Ndërsa për një namaz të dobët që falet larg një përkushtimi të tillë, në një formë të thatë gjeometrike dhe për shtirje, syfaqësi, etj., Allahu i Madhëruar shprehet:

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ . الَّذِينَ هُمْ
عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

“Mjerë për ata, të cilët falen! Të cilët janë të pakujdesshëm për namazet!” (Maun, 4-5)



Përfundimisht, në lidhje me çështjen e namazit duhet t'i përgjyrohemi shumë Zotit (xh.xh.). Duhet të përpiqemi që ta falim namazin me përkushtim dhe frikërespekt ndaj Allahut, sepse namazi është një ibadet i domosdoshëm. Namazi është i domosdoshëm edhe në luftë dhe udhëtim. Përgjatë gjithë historisë islame ushtarët myslimanë i kanë falur namazet në grupe dhe nuk e kanë lënë asnjëherë pas dorë këtë ibadet të rëndësishëm, edhe nëpër beteja.

Për këtë arsye, një besimtar duhet ta konsiderojë lënien e namazit si një fatkeqësi të madhe siç është rënia në zjarr. Andaj, kur në ajetin fisnik flitet për mëkatet e mëdha që i kanë shpjerë banorët e xhenemit në zjarr, njoftohemi se ata do të thonë: **“Nuk ishim prej atyre që e falnin namazin!”** (Mud-deththir, 43)

Zoti (xh.xh.), na e bëftë të gjithëve shumë të dashur namazin! E bëftë namazin dritë të syve tanë dhe miraxh të zemrave tona!..





Fitneja e historicizmit në manipulimin e fesë

Njerëzit, besimi i të cilëve ka zënë mikrobe, përpiqen t'i nxjerrin jashtë funksioni urdhrat kuranor që i duken të vështira nefsit të tyre. Këtë tentativë e kanë quajtur historicizëm. Zoti na faltë, ata po shfaqin guximin të anulojnë dispozitat e Kuranit, duke thënë:

“Këto ajete kanë qenë të vlefshme për atë kohë.” Gjithashtu thonë: “Këto dispozita kanë zbritur sipas kushteve të shekullit të shtatë të kalendarit gregorian.”

Ndërkohë Kurani Fisnik është libri i fundit, Pejgamberi ynë i nderuar është i Dërguari i fundit dhe dispozitat që ka sjellë ai, janë dispozita të vlefshme deri në ditën e kiametit.

Pyetja 7

Perceptimi historicist i Kuranit dhe Islamit, në krye të të cilit vjen Fazllurrahmani në shkallë botërore, në ditët e fundit ka filluar të shtjellohet edhe nga disa teologë në Turqi. Madje në këtë kontekst është thënë se Kurani i ka zbritur Hazreti Pejgamberit si kuptim. Ndërsa ai e ka shndërruar në koncepte dhe fjalë të asaj kohe. Nisur nga ky aspekt, si duhet ta kuptojmë dhe shpjegojmë të qenët e Kuranit mbi historinë dhe mesazhin universal të tij?

Së pari duhet të shprehim këtë:

I Dërguari i Allahut ﷺ, është Pejgamberi i fundit. Ai është i Dërguari i Allahut i kohës së fundit. Nëse do të bëheshin rinovime në Kuranin Fisnik, Allahu Teala mund të dërgonte një pejgamber tjetër.

Shumë ajete të Kuranit Fisnik nxjerrin në pah qartazi se ai (Kurani) i përket i tëri Allahut të Lartësuar, domethënë edhe me kuptimin, edhe me fjalët:

“Në të vërtetë, ty (o Muhamed) po të shpallet Kurani nga ana e një të Urti të Gjithëdijsëm!”

(Neml, 6)

“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (Shuara, 192-195)



Domethënë se Kurani Fisnik është zbritur në zemrën e të Nderuarit tonë dhe nga aty i është dhënë të gjithë umetit.

Për sa i përket fjalëve dhe kuptimit të Kuranit përgjatë procesit të zbritjes, nuk bëhet aspak fjalë për ndonjë lloj ndikimi/ndërhyrjeje të Hazreti Pejgamberit (s.a.s.). Edhe kjo çështje është shprehur qartë në shumë ajete:

“Kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh thonë: “Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!” Thuaj (o Muhamed): “Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe.” (Junus, 15)

“Kur ti (Muhamed) nuk u lexon atyre ndonjë varg nga Shpallja, ata thonë: “Ah! Sikur ta bëje ti vetë”! Thuaju: “Unë ndjek vetëm atë që më ka shpallur Zoti im...” (A’raf, 203)

Edhe këto ajete fisnike e shpjegojnë qartazi se i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, nuk mund të kishte asnjë lloj roli për shprehjen e Kuranit në fjalë:

“Ai është shpallje e zbritur nga Zoti i botëve! Sikur ai (Muhamedi), në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim



atë për dorën e djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës e askush prej jush nuk do të mund ta mbronte. Natyrisht, Kurani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!”

(Hakka, 43-48)

“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kuranit me gjuhën tënde! Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë.” (Kijamet, 16-19)

Prej këtij ajeti fisnik kuptohet se Pejgamberi ynë i Nderuar përgjatë zbritjes së shpalljes është përpjekur për t'i mësuar ajetet përmendësh. Edhe kjo gjendje tregon se ajetet i kanë zbritur atij me fjalët dhe kuptimin e tyre. Po t'i përkisnin fjalët të Nderuarit tonë, **Zot na fal, një përpjekje e tillë do të ishte e pakuptimtë.**

Kurani Fisnik është një mrekulli në fjalë. Diksioni i tij i përket Allahut Teala. Për shembull:

Në vend të رَبِّ الْعَالَمِينَ / el-hamdulil-lahi Rabbi'l-alemin, nuk mund të thuhet الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ / el-hamdulil-lahi ala's-semavati ve'l-ard, sepse bie letërsia, retorika dhe elokuenca.

Përveç të tjerash, Zoti (xh.xh.), premton se do ta mbrojë Kuranin deri në kiamet:



إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.” (Hixhr, 9)

Allahu i Madhëruar nuk ka dhënë ndonjë prem-tim se do t'i mbronte tre librat e tjerë. Andaj edhe ata me kalimin e kohës u manipuluan.

Për këtë arsye asnjë dispozitë e Kuranit Fisnik nuk mund të ndryshohet. Edhe tentativa më e vogël për rinovim është kufër. Me Pejgamberin e fundit ka ardhur mesazhi i fundit.

Edhe këto argumente racionale në lidhje me faktin se Kurani nuk është formuar në mendjen e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), janë të njohura:

- Ndryshimi ndërmjet metodës specifike të Kura-nit që e sfidon njerëzimin, madje që i bën ta ndjejnë veten të dobët qoftë edhe poetët më elokuentë e gojëtarë dhe metodës së haditheve fisnike është shumë i qartë.

- Praktikrat e ixhtihadit të Pejgamberit tonë të Nderuar janë rregulluar disa herë nga Kurani Fisnik pothuajse me një metodë qortimi. Marrja e haraçit nga robërit e luftës së Bedrit, ngjarja e Abesesë, falja e xhenazes së kryetarit të hipokritëve nga Pejgamberi (a.s.), etj.

Po të ishte formuar Kurani Fisnik në kokën e



Pejgamberit (s.a.s.), Zoti na faltë, a do të shpreheshin me këto fjali plot qortime këto lloje ixhtihadesh?

- Po ashtu Pejgamberi ynë i Nderuar nuk bëri dot asgjë veçse të priste pa asnjë rrugëzgjidhje derisa t'i zbriste ndonjë ajet në lidhje me çështjen e Kibles, në ngjarjen e Ifkut dhe në situata të tjera të ngjashme me këto.

Meqë ra fjala, duhet ta themi edhe këtë; mendimet si **historicizmi** përgjatë historisë islame janë përvetësuar nga **grupet ekstremiste si Karmatinët që kanë dalë jashtë Islamit**.

Kurani Fisnik edhe me fjalët, edhe me kuptimin, domethënë me të gjitha aspektet e tij është fjala e Allahut (xh.xh.). Mbi të gjitha, ai ka ardhur deri në ditët e sotme me mbrojtjen e veçantë të Allahut pa iu ndryshuar qoftë edhe një shkronjë. Ai do të vazhdojë pa u ndryshuar deri në kiamet.

Fakti që në asnjërën prej kopjeve të Kuranit Fisnik të cilat gjenden në të katër anët e botës nga e kaluara e deri më sot nuk ka asnjë ndryshim, është një ndër argumentet më të qarta të kësaj të vërtete dhe mrekullie.

Krahas të gjitha këtyre të vërtetave, lëvizjet për manipulimin e fesë islame me mendime imponuese dhe të shpifura është metodë vetëm e misionerëve.



Në këtë manipulim kanë si qëllim veçanërisht këto tri pika:

- Refuzimin e medhhebeve,
- Mohimin e Traditës Profetike,
- Anulimin e dispozitave...

• **E para:** Po përpiqen t'i bëjnë muxhtehidë të vetes të gjithë, madje edhe injorantët që kanë lexuar vetëm dy faqe duke i shfaqur si të panevojshme ixhtihadet dhe medhhebet. Si rrjedhojë e këtyre mendimeve të gjithë, madje edhe njerëzit më të paditur po tentojnë të formojnë një fe sipas perceptimit të tyre, duke thënë: “Sipas meje...”

Ndërkohë të gjitha medhhebet e vërteta janë ekolet e jurisprudencës islame në të cilat janë mbledhur mendimet më të sakta të dijetarëve të përsosur muxhtehidë, duke filluar që nga sahabët e nderuar.

Zgjedhja e njërës prej këtyre është domosdoshmëri. Nuk është e lejuar që të lihen të gjitha njëherësh, sepse të gjitha janë dispozita të ndërtuara mbi themelin e Kuranit dhe Sunetit.

• **E dyta:** Ata që përpiqen të manipulojnë fenë, dëshirojnë që Tradita Profetike të shihet me dyshim. Këtë po e realizojnë me një dredhi që duket si e vërtetë, duke bërë sikur po nxjerrin në plan të parë Kuranin Fisnik.



Ndërkohë Kurani Fisnik është zbritur në zemrën e bekuar të **Pejgamberit** tonë të Nderuar. Ndërsa predikimi, shpjegimi dhe mësimi i Kuranit i përket të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Komentimi më i saktë i Kuranit Fisnik është Suneti i Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.). Suneti është praktikimi i Kuranit. Pra, nuk është diçka ndryshe nga ai. Gjithashtu nuk është diçka që mund të shkëputet prej tij.

Abdullah ibn Dejlemi e shpreh si më poshtë rëndësinë e besnikërisë ndaj Traditës profetike:

“Sipas asaj që më ka ardhur mua, fillimi i ikjes (shkatërrimit) të fesë do të ndodhë me lënien e Sunetit. Siç i zgjidhen fijet litarit një nga një dhe në fund këputet, edhe feja zhduket me braktisjen e suneteve një nga një.” (Darimi, Mukaddime, 16.)

Domethënë se Kurani Fisnik dhe Tradita profetike janë dy arteriet kryesore të Islamit. Pra, janë dy argumentet bazë.

- **E treta:** Sigurisht që Kurani Fisnik ka dispozitat e tij. Ato janë urdhrat absolute të Zotit tonë për ne.

Por njerëzit, besimi i të cilëve ka zënë mikrobe, përpiqen t'i nxjerrin jashtë funksionit urdhrave kurane që i duken të vështira nefseit të tyre. Këto tentativa e kanë quajtur **historicizëm**. Zoti na faltë, ata po shfaqin guximin të anulojnë dispozitat e Kura-



nit, duke thënë: “Këto ajete kanë qenë të vlefshme për atë kohë.” Gjithashtu thonë: “Këto dispozita kanë zbritur sipas kushteve të shekullit të shtatë të kalendarit gregorian.”

Ndërkohë Kurani Fisnik është libri i fundit, Pejgamberi ynë i nderuar është i Dërguari i fundit dhe dispozitat që ka sjellë ai, janë dispozita të vlefshme deri në ditën e kiametit. Edhe pse Allahu i Madhëruar na njofton se e ka plotësuar fenë, kopeja historiciste tenton të ndryshojë dispozitat e ajeteve.

Ndërsa, Allahu Teala thotë në ajetet fisnike:

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14)

“...Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë keqbërësit.” (Bekare, 229)

Në fakt, ky qëndrim i historicistëve i ngjan pikërisht debatit që shejtani bëri kundrejt Zotit (xh.xh.). Siç dihet, kur Allahu i Lartësuar e krijoi Ademin (a.s.), i urdhëroi engjëjt:

“Bëjini sexhde Ademit!”

Sexhdeja për të cilën u urdhëruan këtu, nuk ishte sexhde adhurimi, por sexhde respekti. Por



Iblisi i mallkuar u kaplua nga mendjemadhësia. Atë e pushtoi smira kundrejt Ademit dhe nuk i bëri sexhde. Kështu që e kundërshtoi urdhrin e Allahut (xh.xh.). Kur u pyet se përse nuk i bëri sexhde, në vend që të thoshte:

“Më mashtroi nefsi. Të kërkoj falje, o Zot!..”, bëri një krahasim të pakuptimtë dhe dha mend duke u shprehur me mendjemadhësi:

“Unë jam prej zjarri. Ndërsa Ademi është prej dheu. Unë jam më i lartë se ai!”

Ndërkohë Allahu Teala nuk e kishte pyetur Iblisin:

“Je më i lartë ti, apo Ademi?” Vetëm e kishte urdhëruar që t'i bënte sexhde Ademit. Kurse Iblisi nuk zgjodhi bindjen, por zgjodhi kundërshtimin dhe mallkimin.

Në këtë mënyrë Iblisi ishte i pari që e filloi debatin kundër Allahut (xh.xh.). Për shkak të kësaj paturpësie u përzu nga audienca hyjnore dhe mori ndëshkimin e përhershëm.¹⁵

Përfundimisht, ky stil i të menduarit që e ka bërë flamur qëllimin për:

- Refuzimin e medhhebeve,

15. Shik. A'raf, 12-13; Sad, 71-78, etj.



- Mohimin e Sunetit dhe
- Anulimin e dispozitave të sheriatit,

Është plotësisht i humbur dhe nuk është gjë tjetër veçse një prej kurtheve për ta krishterizuar fenë tonë të lartë, Islamin.

Qëllimi i atyre që nxjerrin këto përçarje, është boshatisja e brendësisë së Islamit siç ka bërë Pavlosi (Pali) në krishterim. Kështu është manipuluar edhe krishterimi. Në fillim e prishën besimin me mendjen e njerëzve nëpër këshilla. Pastaj u hoq ibadeti dhe në vend të tij erdhi mesha. U hoq agjërimi dhe erdhi pehrizi. U hoq mbulesa e gruas, u anulua ligji hyjnor dhe në vend të tij u soll ligji njerëzor.

Lideri i kishës katolike, **Papa Françesko** thotë:

“Mendoj se do të ishte mirë që edhe ata të bënin një punim kritik rreth Kuranit siç e kemi bërë ne për tekstet tona të shenjta. Një metodë komentimi historiko-kritike do t’u mundësojë atyre të zhvillohen.”

Domethënë, ai po thotë se edhe ne duhet ta komentojmë përsëri Kuranin siç i kanë komentuar ata sërish tekstet e tyre të shenjta. Ndërsa historicistët po i shërbejnë këtij projekti të Vatikanit.

Për këtë arsye, edhe marrja e dijes fetare nga një vend i duhur është një çështje jashtëzakonisht



e rëndësishme po aq sa mos nënvlerësimi i dijes fetare. Veçanërisht vëllezërit tanë të rinj duhet të jenë të zgjuar në këto çështje dhe duhet ta mësojnë fenë nga hoxhallarë që janë të devotshëm dhe të qëndrueshëm në rrugën e drejtë. Pejgamberi ynë i Nderuar ﷺ, e ka paralajmëruar kështu Abdullah ibn Omerin ﷺ, i cili ishte një prej sahabëve të cilin e donte shumë:

“O Ibn Omer! Kapu fort pas fesë! Kapu fort pas fesë! Sepse ajo është edhe mishi, edhe gjaku yt. Bëj shumë kujdes se nga kush e mëson fenë! Dijen dhe dispozitat fetare merri nga dijetarët e drejtë dhe jo nga ata që anojnë majtas e djathtas!”





Cilësitë e edukuesit

*Ndërsa zemra dëshiron të fluturojë drejt qiejve,
Këmba më ngec nëpër hijet në tokë...*

(Nexhip Fazëll Kisakyrek)

Një mendimtar thotë:

*“Nëse dëshiron të bëhesh mësues në tokë,
atëherë bëhu nxënës i qiellit!...”*

*Domethënë, edhe vetë duhet të jetosh përgjatë gjithë jetës si një nxënës
i Kuranit dhe Sunetit, edhe për të tjerët duhet të përpiqesh që të
jetojnë në këtë mënyrë. Vetëm atë kohë do të mbledhësh
shumë fryte të marrjes së dijes dhe do të bëhesh mësues i vërtetë.*

Pyetja 8

Mënyra për të ndërtuar një individ dhe shoqëri të mirëfilltë është një edukim i mirëfilltë brenda ekuilibrit materialo-shpirtëror. Mirë, por si mund të edukohet një edukues i mirëfilltë që ta japë këtë edukim? Cilat attribute duhet të gjenden te një edukues ideal?

Allahu i Lartësuar i ka dërguar peygamberët si edukuesit më të mëdhenj njerëzor. Për këtë arsye, edukimi, pra të shërbyerit si një edukues është profesion profetik.

Mësuesi i vetëm i të Dërguarit të Allahut ﷺ, është Allahu (xh.xh.). Ai nuk ka marrë mësim nga asnjë njeri. Megjithëkëtë qëndronte në pikën kulmore të çdo lloj dijeje që sot i flasin njeriut dhe që analizojnë shpirtin e tij si psikologjia, pedagogjia dhe socio-antropologjia.

Një mendimtar thotë:

“Nëse dëshiron të bëhesh mësues në tokë, atëherë bëhu nxënës i qiellit!..”

Domethënë, edhe vetë duhet të jetosh përgjatë gjithë jetës si një nxënës i Kuranit dhe Sunetit, edhe për të tjerët duhet të përpiqesh që të jetojnë në këtë mënyrë. Vetëm atë kohë do të mbledhësh shumë fryte të marrjes së dijes dhe do të bëhesh mësues i vërtetë.



Objekti që e rregullon, është kartëvizita e një tekniku. Edhe cilësia e edukuesit matet me nxënësit që edukon.

Mjeshtëria e çdo artisti kuptohet nga veprat që ai nxjerr në pah. Për këtë arsye, edhe Pejgamberi ynë i Nderuar i cili edukoi brezin e sahabëve që ishin prej shoqërisë së injorancës, është edukuesi më i përsosur që ka parë njerëzimi.

Siç merr njeriu nga gjendja e atij ndaj të cilit ndjen dashuri, edhe njeriu që fiton grada në dashurinë ndaj Resulullahut (s.a.s.), merr pjesë nga atmosfera shpirtërore e tij. Për shkak të kësaj gjendjeje bëhet më i suksesshëm në ushtrimin e detyrës prej edukuesi.

✿ Një edukues së pari duhet të ndërtojë veten, pastaj duhet të përpiqet të edukojë të tjerët, sepse një njeri që nuk mund të ndërtojë veten, nuk mund t'i ndërtojë të tjerët. Nuk mund të ketë qerasje me gotë të zbrazët.

Një edukues duhet ta zhvillojë vazhdimisht veten. Në të kundërt, mund të shuhen shumë aftësi për shkak të nënvlerësimit të tij. Një edukues që e shndërron në një fidan një metër nxënësin e tij, i cili në aspektin e aftësisë është si një rrap madhështor, është përgjegjës tek Allahu (xh.xh.).

Nuk duhet të harrohet se:



“Shpërdorimi më i keq është shpërdorimi i njeriut.”

“Për çdo njeri që fitojmë, kemi shpërblim të madh. Për çdo njeri që humbim, kemi mëkat të madh.”

Për të qenë një edukues i mirëfilltë, duhet që ndjenjat t'i kemi të forta, sepse kur të formojmë lidhje me nxënësit, duhet t'i kuptojmë ndjenjat e tyre, t'i vlerësojmë ato dhe të veprojmë me ta sipas këtyre. Andaj edhe një mjek, para se të japë mjekimin, përpiket të gjejë diagnozën, domethënë përpiket të kuptojë shkakun e dhimbjes dhe shqetësimit. Të mos harrojmë se vetëm njeriu të cilit i zgjidhet problemi, mund të fitohet.

Allahu i Lartësuar thotë në ajetin fisnik:

تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ

“...Ti i njeh ata nga pamja e tyre...” (Bekare, 273)

Andaj duhet t'i kuptojmë hallet e bashkëbiseduesit dhe të gjejmë një damar që arrin deri në zemrën e tij. Përpjekja e vazhdueshme për t'i mësuar njeriut disa gjëra pa i kuptuar hallet dhe vështirësitë e tij, nuk mund të japë një rezultat pozitiv.

✽ Njerëzit, siç kanë të ndryshme aftësitë, kanë të ndryshme edhe dobësitë. Andaj edhe edukuesi duhet t'u afrohet njerëzve me përkushtimin e pothuajse një mjeku shpirtëror. Një metodë apo këshillë që është



e dobishme për dikë, mund të jetë e dëmshme për dikë tjetër. Për këtë arsye, duhet t'i njohim shumë mirë karakteret e njerëzve për edukimin e të cilëve jemi përgjegjës.

Duhet të marrim shembull nga **Daru'l-Erkami** dhe nga **Suffa**. Për shembull, i **Dërguari i Allahut** ﷺ, e edukoi me një mënyrë të veçantë **Hazreti Ebu Bekrin** i cili e kishte zemrën të mbushur me mëshirë. Nga ana tjetër, e edukoi në një formë ndryshe **Hazreti Omerin**, i cili kishte një natyrë të ashpër dhe me një edukim krejt tjetër **Muadh ibn Xhebelin**, **Enes ibn Malikun** dhe **Vahshiun** nga Abisinia. Në fund të këtyre edukimeve të ndryshme të gjithë u bënë personalitete vje.

Një shoqëri ka nevojë për çdo profesion. Ai që ka prirje për matematikë, duhet të orientohej drejt matematikës. Ndërsa ai që ka prirje për poezi, duhet të orientohej drejt poezisë. E rëndësishme është që aftësive t'u jepet orientimi i duhur.

🌿 Edukuesit (mësuesit) ndërtojnë një botëkuptim duke ndikuar në organet më të rëndësishme të nxënësve, domethënë në zemrat dhe trurin e tyre. Nisur nga ky këndvështrim edukuesit mund t'i quajmë **“arkitektët e së ardhmes”**.

Bazuar në këto që thamë, edukuesi në çdo fazë të jetës së tij dhe veçanërisht në klasë duhet të



veprojë në një formë që i ka hije personalitetit të tij Islam. Ai nuk duhet të harrojë se çdo vepër që bën dhe çdo fjalë që thotë është në pozicionin e një tulle që vendoset në personalitetin e nxënësit.

Edukuesi duhet të mendojë edhe për faktin se gabimet e tij mund të kopjohen nga ata që edukon. Ai duhet ta ndjejë thellë në zemër përgjegjësinë e kësaj.

🕋 Edukuesi duhet ta shohë çdo njeri që i dorëzohet atij, me vetëdijen e amanetit të Allahut Teala.

Bariu është përgjegjës për kopenë e tij. Ai është i detyruar ta mbartë në krahë një qengj që i thyhet këmba. Pikërisht kështu edhe nxënësit janë nën përgjegjësinë e edukuesit.

Pejgamberi ynë i Nderuar ﷺ, thotë: *“Të gjithë jeni barinj. Bariu është përgjegjës për kopenë e tij...”* (Buhari, Vesaja, 9.)

Të jesh përgjegjës (edukues) në kohët e sotme, do të thotë të jesh përgjegjës, jo për karakteret e buta si delet, por për karakteret e vështira dhe inatçie si dhia.

Edhe pejgamberët kanë qenë barinj, në mënyrë që të përgatiteshin për të ardhmen, sepse:

-Bariu e kupton gjendjen shpirtërore të kopesë të cilën ruan.



-Bariu e kullot, e le të pushojë dhe e ushqen kopenë e tij në vende me bar. Ai nuk e çon atë në vende të thata.

-Bariu e mbron kopenë nga ujqërit.

-Bariu nuk u lë ujqërve as edhe një qengj që është i sëmurë, por e merr atë në krahë dhe e bashkon me kopenë.

-Bariu e kontrollon gjithmonë kopenë për të cilën është përgjegjës, duke ecur nganjëherë para dhe nganjëherë pas saj.

ﷻ Edukimi nuk është një punë që kryhet duke qëndruar ulur. I Nderuari ynë ﷺ, përpëltej për t'ua predikuar Islamin njerëzve. Ai asnjëherë nuk tha: "Le të vijnë që t'ua shpjegoj." Por mori parasysh qoftë edhe gjuajtjen me gurë dhe shkoi në Taif. Përgjatë kthimit gjeti një skllav. Edhe atij ia predikoi menjëherë Islamin. Nuk i kaloi asnjë mundësi pa vlerësuar.

Edhe besimtari duhet të kërkojë në çdo moment një mundësi për të dhënë shërbim fetar. Nëse e kërkon, Allahu do t'ia nxjerrë përpara. Por ai që nuk e shndërron në vetëdije kërkimin e shërbimit fetar, është i shkujdesur edhe nëse përpara i dalin mundësi të pafundme shërbimi.

ﷻ Çelësi i vërtetë i suksesit në edukim është durimi, qëndrueshmëria dhe sakrifica.



Asnjë përrua apo asnjë lum nuk mund të ngjitet në mal. Për ta kaluar malin duhet të ecin patjetër përreth tij. Nëse veprohet kështu, rruga që përshkohet është e gjatë, por arrihet qëllimi dhe synimi i kërkuar. Edhe edukimi i njeriut kërkon një durim, qëndrueshmëri dhe përpjekje të tillë.

Durimi i periudhës së Mekës rezultoi me zhvillimin e periudhës së Medines. Për gjashtë vjet u bënë 40 myslimanë. Për njëzet e tre vjet u bënë 150 mijë myslimanë.

✿ Edukimi merr fund aty ku gjendet dobësia, dembelizmi, lodhja, ankesa dhe mungesa e durimit. Kapitali i edukimit është dashuria dhe përpjekja.

Edukimi është arti për të harruar ankesën kundrejt vështirësisë. Sahabët nuk u lodhën, nuk u dorëzuan dhe nuk hoqën dorë asnjëherë kur shkuan në Kinë dhe Semerkand.

✿ Të qenët një edukues i dashur është një art i madh.

Të mos harrojmë se në edukim;

1. Ndikojmë aq sa i duam nxënësit.

2. Duhemi aq sa i duam nxënësit.

Kapitali i edukimit është dashuria. Dashuria zgjidh çdo problem. Njeriu, të cilit ia zgjidhim problemin, është njeriu ynë.



Dashuria që ndjehet ndaj një edukuesi e shton edhe interesimin ndaj atyre që jep ai. Nëse edukuesi (mësuesi) i trajton nxënësit me dashuri dhe mëshirë, bën të mundur që mesazhet e tij të transmetohen nëpërmjet një rruge shpirtërore më shumë se asaj racionale. Kjo është një metodë më influencuese edukimi.

❁ Edukuesi duhet të ndajë kohë për nxënësit e tij edhe jashtë orarit të punës. Ai nuk duhet të jetë si një nëpunës që shtyp kartën sa herë që hyn e del nga vendi i punës apo si një nëpunës që hedh firmën në fletoren e mungesave.

❁ Mësuesi (edukuesi) duhet të përhapë energji pozitive me fytyrën e qeshur dhe gjuhën e ëmbël. Mësimin dhe edukimin duhet ta fillojë së pari duke ua bërë të dashur nxënësve. Të mos harrojmë se çdo njeri zbutet kundrejt bukurisë së mirësisë dhe magjepset ndaj gjuhës së ëmbël dhe fytyrës së qeshur.

Ekstremizmi në ashpërsi lindi urrejtje. Edhe teprimi në tolerancë e dobëson autoritetin. Suksesi arrihet duke mbajtur ekuilibrin ndërmjet këtyre të dyjave.



Mehmet Akif Ersoji shprehet:

Për të thënë “jam mësues”, së pari duhet të jesh besimtar;



Pastaj i kulturuar, i kualifikuar dhe i ndërgjegjshëm.

Pa i pasur këto katër cilësi, kjo punë nuk mund të kryhet, sepse detyra është madhore...

Kushti i 1-rë: **Të qenët besimtar.** Domethënë, edukuesi duhet të jetë një besimtar që përhap mëshirë nga shpirti si shembull me jetën e tij në besim dhe adhurim.

Kushti i 2-të: **Të qenët i kulturuar.** Domethënë, edukuesi duhet të jetë shembull në veprat dhe sjelljet e tij.

Kushti i 3-të: **Të qenët i kualifikuar.** Ai duhet ta edukojë veten në mënyrë të mirëfilltë.

Kushti i 4-të: **Të qenët i ndërgjegjshëm.** Ai duhet të posedojë vetëdijen e përgjegjësisë. Pra, duhet ta konsiderojë veten përgjegjës për nxënësit e tij.



Këto tri pika janë shumë të rëndësishme në edukim:

1. Vlerësimi që ne i bëjmë nxënësit.
2. Vlerësimi që nxënësi na bën neve. (Dashuria)
3. Vlerësimi që do të na bëjë Allahu i Lartësuar në ditën e kiametit.



Të mos harrojmë se të gjithë jemi dijetarë të asaj që dimë dhe nxënës të asaj që nuk dimë. Të gjithë jemi nxënës që do të dalim nga shkolla e kësaj jete me frymën e fundit dhe do të shkojmë në audiencën hyjnore.

Siç presin nxënësit nga mësuesit një diplomë me nota të larta në fund të semestrit, edhe Zoti pret kërkon prej nesh një diplomë jete të mbushur plot me vepra të mira.

Zoti na e dhëntë dhe mundësoftë të gjithëve të dalim në audiencën e tij me një libër veprash të mira!..





Gjallërimi i kohës para agimit me adhurime

Hazreti Mevlana thotë:

“Këtë seher (kohë para agimi) mu ndërpre frymëzimi.

*E kuptova se në trupin tim kishin
hyrë disa kafshata të dyshimta.”*

*Domethënë se duhet ta kërkojmë gjithmon
ëshkakun e sëmundjes dhe të marrim masa.*

*Siç ka mjek kujdestar në mjekësi, edhe në përshtpirtshmëri
është e domosdoshme që të kemi një mjek
shpirtëror kujdestar për zemrën...*

Pyetja 9

Ndërmjet mendimeve dhe planeve tona ka synime të bukura si përpjekja për të falur namaze nafile si shtesë ndaj farzeve, duke mos shfaqur mangësi veçanërisht në adhurimet e natës, por po kemi vështirësi në praktikimin e tyre. Si mund t'i shndërrojmë në vepra këto mendime?

Nëse nuk mund të ngrihemi në kohën para agimit (sigurisht që jo në situata kur jemi sëmurë), atëherë duhet t'i hedhim një shikim ditës:

-A më kanë shkuar sytë në ekrane të gabuara apo në pamje të gabuara?

-A më ka thënë gjuha fjalë të gabuara?

-A më kanë dëgjuar veshët zëra të gabuar? A kanë dëgjuar thashetheme, fjalë boshe dhe gjëra të tilla?..

-A ka hyrë në stomak ndonjë kafshatë haram apo e dyshimtë?

✽ **Hazreti Mevlana** thotë:

“Këtë seher (kohë para agimi) mu ndërpre frymëzimi.

E kuptova se në trupin tim kishin hyrë disa kafshata të dyshimta.”

Domethënë se duhet ta kërkojmë gjithmonë



shkakun e sëmundjes dhe të marrim masa. Siç ka mjek kujdestar në mjekësi, edhe në përshpirtshmëri është e domosdoshme që të kemi një mjek shpirtëror kujdestar për zemrën...

✽ Dikush shkoi te **Ibrahim ibn Ed'hemi** dhe i tha:

“I nderuar! Nuk ngrihem dot për të bërë ibadet natën. Më jepni një rrugëzgjidhje!” Hazreti i dha këtë përgjigje:

“Mos i bëj mëkat Allahut përgjatë ditës (domethënë, mbroje veten nga gjendjet dhe veprimet që e dëmtojnë përshpirtshmërinë tënde), në mënyrë që Ai të të zgjojë dhe të të pranojë në audiencën e Tij. Prezenca në audiencën e Tij përgjatë natës është një nder sublim. Mëkatarët nuk arrijnë ta fitojnë dot këtë nder!”

✽ Koha para agimit është koha më e pranueshme dhe më e begatë për të bërë istigfar, domethënë për të kërkuar falje nga Allahu Teala. Andaj Zoti i Madhëruar thotë:

وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ

“... Ata që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” (Al Imran, 17) Në këtë mënyrë Zoti (xh.xh.), i fton robërit e Tij që të bëjnë istigfar në këtë kohë. Allahu i Lartmadhëruar i hap deri në fund dyert e faljes në kohën e seherit (para agimit).



A nuk kemi nevojë për faljen hyjnore? Kemi shumë madje!.. Atëherë duhet të zgjohemi për ta kaluar me adhurim kohën e seherit.

Siç kemi qendra fizike në trupin tonë, për shembull zemra, mushkëritë, mëlçia, stomaku, etj., kemi edhe qendra të tilla shpirtërore. Këto i quajmë “letaif”. Këto letaif duhet t’i zbukurojmë me begatinë e kohës para agimit.

I Dërguari i Allahut ﷺ, falte namaz nate gjatë e gjatë në kohën e seherit. Madje nuk e linte pa falur këtë namaz nate as përgjatë udhëtimeve të vështira në shkretëtirë.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Dita e ringjalljes është një ditë shumë e nxehhtë. Andaj agjëro që tani për t’u freskuar atë ditë. Fal dy rekatë namaz nate në errësirën e natës për vetminë e varrit.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 165.)

Domethënë se seheri në atë kohë të zymtë nga një aspekt është parapërgatitje për hyrjen në atmosferën e varrit. Nuk ka rrugëzgjdhje, patjetër që një ditë do të hyjmë në atë botë. Sa më shumë që ta kalojmë kohën e seherit me ibadete, aq më shumë do të kemi dobi (prej ibadeteve) në botën e varrit.

✽ Dikush e pa në ëndërr pas vdekjes Hazreti **Xhunejd Bagdadin**, i cili ishte prej miqve të Allahut. E pyeti:

“Ç’kemi, o nipi i të Dërguarit të Allahut?” Ai iu përgjigj duke i thënë:

“Fjalitë e dijes që kemi lexuar, mbetën në qoshe. Edhe shenjat e zbulimit shpirtëror mbetën në qoshe. Neve nuk na bëri dobi asgjë përveç rekateve që kemi falur në mes të natës.”

Për këtë arsye namazi i natës është shumë i rëndësishëm!

Përsëri **Pejgamberi ynë i nderuar** ﷺ, thotë:

“Aman, përpikuni të ngriheni natën, sepse ky veprim ishte tradita e të devotshmëve para jush dhe është shkak për t’u afruar te Allahu. (Ky adhurim) të mbron nga mëkatet, është falje për gabimet dhe i largon sëmundjet nga trupi.”

(Tirmidhi, Deavat, 101/3549.)

Për këtë arsye, motrat dhe vëllezërit e mi të rinj, le të përpiqemi me singeritet për ta kaluar natën me adhurim, inshallah!..





Nderi dhe turpi

*Nderi është një prej cilësive dalluese
që e ndan njeriun nga krijesat e tjera.*

*Allahu i Lartësuar kërkon që robi ta ruajë gjithmonë nderin.
Ai kërkon nder për veshët, nder për gjuhën, nder për sytë,
nder për duart, shkurtimisht nder për të gjithë trupin...*

*Kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.),
bëri hixhret në Medine, rregulloi menjëherë tregun.
Bazuar në këtë, edhe ne duhet t'i ndërtojmë përsëri dhe sipas
parimeve të Islamit shkollën, tregun, industrinë, arkitekturën,
qytetin dhe çdo gjë tjetër që kemi.*

Pyetja 10

Çfarë duhet të na kujtojë “ndjenjat e nderit” në një shoqëri ku po abuzohet çdo ditë që kalon me konceptet si “edukata, turpi dhe namusi”. Në cilat situata mund të takohen gruaja dhe burri pa qenë të martuar? Çfarë na sugjeroni në lidhje me këtë çështje?

Nderi është një prej cilësive dalluese që e ndan njeriun nga krijesat e tjera. Allahu i Lartësuar kërkon që robi ta ruajë gjithmonë nderin. Ai kërkon nder **për veshët, nder për gjuhën, nder për sytë, nder për duart, shkurtimisht nder për të gjithë trupin...**

Përse?

Sepse mungesa e nderit në gjuhë e shpie njeriun në përgojim, gënjeshtër dhe shpifje.

Mungesa e nderit te sytë e zvarrit njeriun për të parë vitrina të gabuara, ekrane të papërshtatshme dhe skena që janë haram.

Mungesa e nderit te veshët e drejton njeriun për të dëgjuar gjëra të këqija.

Mungesa e nderit te duart e hedh njeriun në mëkat.

Edhe veshja e një rrobe të ngushtë deri në atë masë sa t'i shfaqë linjat e trupit, të një rrobe joshëse



deri në atë masë sa t'i tërheqë sytë e të tjerëve dhe të një robe që e bën atë të cilin e shikon, të thotë: **“Eja te unë!”**, siç i tha Zulejhaja Hazreti Jusufit, është privim i trupit nga nderi. Kjo gjendje e zvarrit njeriun drejt shkatërrimit shpirtëror.

Ndërsa urdhri i Zotit (xh.xh.), në lidhje me këtë çështje është veshja e rrobave të bollshme që nuk i shfaqin linjat e trupit.

❁ **I Dërguari i Allahut ﷺ** ka thënë:

“Turpi është prej besimit.” (Buhari, Edeb 77, Iman 16; Muslim, Iman, 57-59.)

“Një prej gjërave që frikësohem më së shumti për ju, janë dëshirat e flakta që ju zvarrisin drejt tërbimit në lidhje me çështjen e stomakut dhe nderit. Ndërsa tjetra është egoja e cila ju lëshon në devijim.” (Ahmed, IV, 420, 423; Hejsemi, I, 188; Ebu Nuajm, Hilje, II, 32.)

❁ Ndërsa në lidhje me përzierjen e burrave me gratë le të themi këtë:

Shoqëria e Epokës së Lumturisë (Periudhës së të Dërguarit të Allahut) ishte shumë e kujdesshme dhe e ndjeshme për sa i përket çështjes së përzierjes së burrave me gratë. Domethënë, burrat dhe gratë që ishin të huaj për njëri-tjetrin, nuk qëndronin bashkë dhe nuk përzihehin deri në atë masë, sa t'i kalonin kufijtë dhe rregullat.



Përgjatë jetës së tyre sociale kishte vazhdimisht një largësi ndërmjet burrave e grave dhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin ishin brenda një rregulli dhe disipline të caktuar.

Sepse Islami si parim, siç i ka ndaluar të këqijat, si marrje masash në mënyrë paraprake, i ka ndaluar edhe gjendjet dhe veprimet që bëhen shkak për të keqen dhe që nxisin drejt saj. Kështu i mbyll në mënyrë të mirëfilltë rrugët e gabuara, duke vendosur një largësi të madhe ndërmjet njerëzve dhe të këqijave.

Për fat të keq, në ditët e sotme në familje po përjetohen situata tragjike, ngaqë nuk po shfaqet kujdes ndaj këtyre rregullave.

Në ditët e sotme disa prej njerëzve thonë: “Sidoqoftë femrat dhe meshkujt janë bashkë nëpër rrugë dhe sokakë. Andaj le të jenë edhe në klasë, në dyqan, në apartament, etj. Çfarë të keqeje ka këtui?”

Të mos harrojmë se në rrugë dhe sokak rastisin në një mënyrë krejt të pacaktuar. Por edhe aty ka rregulla si ulja e shikimit dhe mbulesa.

Ndërsa kur bëhet fjalë për të njëjtën shkollë dhe për të njëjtin vend pune, dashje pa dashje ndodh një lloj afrimiteti, ndodhin biseda të panevojshme dhe shfaqen anime të zemrës. Nëpër vendet e punës mund të ndodhin situata kur lind nevoja e qëndrimit



vetëm për vetëm. Siç shprehet edhe në hadithin fisnik, kur ndodh diçka e tillë, “*i treti i tyre është shejtani*”¹⁶.

Ne duhet të jemi të vetëdijsëm për këtë:

Rregullat e sistemit të jetës në ditët e sotme i kanë vendosur njerëz që nuk u kushtojnë rëndësi principeve fetare. Ne si myslimanë duhet t’i ndërtojmë përsëri të gjitha këto rregulla. Këtë duhet ta bëjmë sipas fesë sonë dhe me parimet sublime të Islamit.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, bëri hixhret në Medine, rregulloi menjëherë tregun. Bazuar në këtë, edhe ne duhet t’i ndërtojmë përsëri dhe sipas parimeve të Islamit shkollën, tregun, industrinë, arkitekturën, qytetin dhe çdo gjë tjetër që kemi.





Vatra e qetë familjare

*Babai im i ndjerë, Musa Efendi
u jepte këtë këshillë të rinjve të sapomartuar:*

*“Bashkëshorti dhe bashkëshortja duhet të jenë të
mëshirshëm kundrejt njëri-tjetrit. Butësia dhe mëshira e
vërtetë kuptohet duke e mbështetur njëri-tjetrin në rrugë
të Allahut (xh.xh.). Nëse e zgjoni njëri-tjetrin për namaz
nate dhe namaz të mëngjesit, atëherë kjo është një shenjë që
tregon mëshirën e vërtetë që keni ndaj njëri-tjetrit.”*

Pyetja 11

Ndaj cilave gjëra duhet të bëjmë kujdes për të pasur prehje në shtëpi? Çfarë këshille mund t'u jepni të rinjve të sapomartuar? Çfarë detyrash kanë kundrejt njëri-tjetrit pjesëtarët e familjes?

Paqja e shoqërisë është e lidhur me jetesën e ndershme të individëve. Kjo është e mundur vetëm me një institucion (vatër) të qetë familjare e cila është e lidhur me përsipirtshmërinë e martesës.

Tri çështje që janë të nevojshme për një familje të qetë, janë shprehur si më poshtë në ajetin fisnik:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا
لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يُتَفَكَّرُونَ

“Dhe një prej shenjave të Tij (domethënë, ekzistencës së Allahut) është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rum, 21)

لِتَسْكُنُوا / **Li teskunu: Paqe dhe qetësi:**

Nëse në familje ka prehje, atëherë kjo prehje përhapet në çdo fazë të jetës dhe në shoqëri.



مَوَدَّة / **Meveddeten: Dashuri:**

Qendra e dashurinë është Zoti i Madhëruar. Nëse jeta familjare i orienton bashkëshortët drejt qendrës së dashurisë, atëherë shijohet kënaqësia e vërtetë e dashurisë.

رَحْمَةً / **Merhamet: Mëshira:**

Mbështetja ndaj njëri-tjetrit në çdo sprovë të jetës...

Babai im i ndjerë, Musa Efendi u jepte këtë këshillë të rinjve të sapomartuar:

“Bashkëshorti dhe bashkëshortja duhet të jenë të mëshirshëm kundrejt njëri-tjetrit. Butësia dhe mëshira e vërtetë kuptohet duke e mbështetur njëri-tjetrin në rrugë të Allahut (xh.xh.). Nëse e zgjoni njëri-tjetrin për namaz nate dhe namaz të mëngjesit, atëherë kjo është një shenjë që tregon mëshirën e vërtetë që keni ndaj njëri-tjetrit.”

✽ Siç duhet të veprojmë në çdo çështje, edhe për sa i përket vatrës së qetë familjare duhet të marrim si shembull **të Dërguarin e Allahut** ﷺ:

Si ishte shtëpia e Resulullahut ﷺ?

-Ajo vatrë ishte vatra më e lumtur e kësaj bote.

-Prej asaj vatre përhapej valë-valë aroma e lumturisë.



-Në atë vatër kalonin ditë pa pasur një gjellë të ngrohtë, por aty jetohej me kënaqësinë e pranimit të kaderit, durimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.).

-Gratë dhe fëmijët në atë vatër, nëse e shohim me syrin e kësaj bote, nuk kishin ndonjë mirëqenie të madhe, por **i Dërguari i Allahut** ﷺ, kishte një dashuri të madhe për ta.

-Pejgamberi ynë i Nderuar i donte shumë dhe i nderonte fëmijët e tij. Ai i këshillonte gjithmonë ata që të ishin të devotshëm.

Bazuar në këto që thamë më sipër, prindërit më të mirë janë ata prindër që mund t'u lënë fëmijëve të tyre trashëgimi besimin në botën e përtejme.

✿ Metoda e edukimit që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), përdori në jetën familjare, lindi një besnikëri dhe dashuri të pafundme në zemrat e bashkëshorteve dhe fëmijëve të tij.

Asnjë grua nuk mund ta dojë bashkëshortin e saj, aq sa e kanë dashur bashkëshortet e bekuara të Dërguarin e Allahut (s.a.s.).

Asnjë burrë nuk mund të duhet nga bashkëshortja e tij, aq sa është dashur Resulullahu, alejhi's-selam, nga bashkëshortet e tij të bekuara.

Po ashtu, asnjë fëmijë nuk mund ta dojë babanë e tij, aq sa e ka dashur Hz. Fatimeja babanë e saj (Pejgamberin a.s.).



Asnjë baba nuk mund t'i dojë fëmijët e tij, aq sa i ka dashur Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.).

Domethënë se baza e prehjes në familje është e lidhur me mundësinë tonë për të marrë mësim nga devotshmëria e madhe që ekzistonte në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

5 KUSHTET E MARTESËS TË SUKSESSHME:

- Dashuria
- Besnikëria
- Respekti i ndërsjellë
- Durimi dhe
- Përgjegjësia

Dashuria: Burimi i dashurisë është Allahu Teala i cili është “el-Vedud”. Bashkëshorti dhe bashkëshortja duhet ta shtojnë dashurinë në mënyrë të përshtatshme me kënaqësinë e Allahut dhe të gjejnë ndonjë formë për t'i hyrë në zemër njëri-tjetrit.

Besnikëria: Sakrifica e palëve këto kohët e fundit. Ne nuk duhet ta harrojmë vitin e pikëllimit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Respekti i ndërsjellë: Sinqeritetin nuk duhet ta shndërrojmë në fjalë të padobishme, dinjitetin nuk duhet ta shndërrojmë në mendjemadhësi, modestinë nuk duhet ta shndërrojmë në nënçmim... Kufijtë duhet të ruhen në mënyrë reciproke.



Durimi: Bashkëshortët duhet të mendojnë për cilësitë e mira të njëri-tjetrit në kohë të vështira dhe duhet të bëjnë durim duke i kujtuar ato. Andaj në një hadith fisnik thuhet:

“Një besimtar nuk (duhet) ta urrejë bashkëshorten e vet. Nëse nuk i pëlqen ndonjë cilësi e saj, i pëlqen ndonjë cilësi tjetër.” (Muslim, Rada', 61.)

Ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes nuk duhet të ndodhin debate, por edhe nëse ndodhin, duhet të bëhen në ndonjë vend ku nuk i shohin fëmijët. Pra, duhet të bëhen pa u shkaktuar ndonjë dëm fëmijëve.

Përgjegjësia: Bashkëshortët nuk duhet t'i nënvlerësojnë detyrat që kanë kundrejt njëri-tjetrit.

Të dyja palët duhet t'i respektojnë njëjtë prindërit e njëri-tjetrit.

Veçanërisht fëmijët të cilët janë një amanet hyjnor, duhet të pajisen me besim dhe moral të lartë. Trashëgimia më e vlefshme që mund t'u lënë prindërit fëmijëve, është edukimi i tyre në rrugë të Allahut, përpjekja për shpëtimin e tyre të përherëshëm dhe mbajtja gjithmonë në plan të parë të shqetësimit për të ardhmen e botës tjetër kundrejt shqetësimit të së ardhmes në këtë botë.





Rregulla rreth marrëdhënieve me jomyslimanët

Myslimani nuk duhet ta humbë vlerën e tij pikërisht si një flori, edhe nëse bie në baltë. Madje ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm kundrejt gjendjes dhe sjelljeve të tij kur ndodhet nëpër vende të huaja. Ai nuk duhet ta nxjerrë nga mendja, se edhe një gabim krejt i vogël që mund të bëjë si individ, i faturohet Islamit.

Sikundër kësaj, duhet të mendojë se edhe sjelljet e bukura që mund të shfaqë, e shtojnë dashurinë dhe interesimin ndaj Islamit në zemrat e njerëzve dhe duhet të përpiqet për këtë.

Pyetja 12

Si mund ta mbrojë veten një mysliman nëpër vende të huaja? Ndaj cilave gjëra duhet të bëjë kujdes në marrëdhëniet me jomyslimanët?

Allahu i Lartësuar e ka bërë të gjithë tokën një vend sprove për ne. Kudo që myslimani të ndodhet në këtë botë dhe në cilën shoqëri të që të gjendet, duhet ta shfaqë personalitetin dhe karakterin e Islamit.

Myslimani nuk duhet ta humbë vlerën e tij pikërisht si një flori, edhe nëse bie në baltë. Madje ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm kundrejt gjendjes dhe sjelljeve të tij kur ndodhet nëpër vende të huaja. Ai nuk duhet ta nxjerrë nga mendja, se edhe një gabim krejt i vogël që mund të bëjë si individ, i faturohet Islamit. Duhet të bëjë kujdes me një përkushtim edhe më të madh ndaj sjelljeve negative që e dëmtojnë imazhin e Islamit.

Sikundër kësaj, duhet të mendojë se edhe sjelljet e bukura që mund të shfaqë, e shtojnë dashurinë dhe interesimin ndaj Islamit në zemrat e njerëzve dhe duhet të përpiqet për këtë. Ai duhet të përpiqet për t'ia treguar njerëzimit fytyrën e qeshur të Islamit me gjendjen dhe veprimet e tij. Këtë duhet ta konsiderojë si një mundësi për arritjen e lumturisë në botën e përtejme.

Transmetohet se **i Dërguari i Allahut** ﷺ i ka



thënë **Hazreti Aliut** dhe nëpërmjet tij të gjithë myslimanëve:

“O Ali! Nëse Allahu e udhëzon një njeri me dorën tënde, kjo është më e mirë për ty se çdo gjë mbi të cilën lind dielli.” (Hakim, Mustedrek, III, 690.)

Në Kuranin Fisnik thuhet si më poshtë në lidhje me këtë çështje:

“...Nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...” (Maide, 32)

Resulullahu, alejhi's-selam, i edukonte sahabët dhe më pas i dërgonte nëpër vende të huaja. Pra, i dërgonte në Kinë, Semerkand dhe Jemen.

Domethënë se një mysliman duhet detyrimisht të shfaqë personalitetin dhe karakterin Islam në çdo kohë dhe në çdo vend. Në këtë mënyrë mbron veten dhe bëhet shkak për udhëzimin e të tjerëve, nëse e ka kështu.

Shërbimi i predikimit të fesë është kapitali më i vlefshëm për botën tjetër. Por predikimi i fesë nuk bëhet vetëm me fjalë. Predikimi që bëhet duke u praktikuar, është predikimi më influencues.

Një ditë **Omeri** ﷺ, tha:

“Bëhuni ftuesit e njerëzve pa folur!” Atij i thanë:

“O kalif! Si mund të bëhemi ftues pa folur?”

Ai tha:

“Me gjendjen dhe moralin tuaj...”



Njerëzit mahnitën ndaj personalitetit dhe karakterit. Ata shkojnë pas karakterit dhe personalitetit të lartë. Për këtë arsye, cilësia dalluese e një myslimani të vërtetë është ekspozimi i personalitetit dhe karakterit Islam me mënyrën e të jetuarit.

Edhe këtë nuk duhet ta harrojmë; vlera e një fitoreje është sa vështirësitë që janë duruar për ta arritur atë. Pikërisht si bonusi që u jepet atyre që ushtrojnë detyrën në vende të vështira, aq i madh është edhe shpërblimi për ata që i zbatojnë urdhrat e Allahut dhe e predikojnë fenë në kushte të vështira.

Përveç të tjerash, nuk është e drejtë që shërbi-min ndaj Islamit ta konsiderojmë si detyrë vetëm të klerikëve fetarë apo të atyre që kanë mbaruar fakultetin e teologjisë. Çdo mysliman duhet të jetë shërbëtori i fesë së tij.

Përgjatë gjithë historisë nderimi i shumë vendeve me udhëzimin e Islamit ka ndodhur nëpërmjet tregtarëve që kanë shfaqur moralin Islam. Ai që e jep udhëzimin është vetëm Allahu (xh.xh.). Ajo që duhet të bëjë njeriu është që të përpiqet aq sa ka mundësi në këtë rrugë.



PËRMBAJTJA

Njeriu i Mëshirës	7
1. Reflektimi i mëshirës në botën e mendimit.....	18
2. Reflektimi i mëshirës në zemër.....	22
3. Reflektimi i mëshirës në gjuhë.....	26
4. Reflektimi i mëshirës te sytë.....	28
5. Reflektimi i mëshirës te duart	29
6. Reflektimi i mëshirës te pozita.....	29
7. Reflektimi i mëshirës te pasuria	30
8. Reflektimi i mëshirës te personaliteti.....	31
Shoqëria e mëshirës.....	35
Çfarë njerëzish ishin njerëzit e civilizimit islam?	40
Dija dhe edukimi i dobishëm.....	65
Nga e ka marrë perëndimi dijen dhe teknikën?	79
Shfrytëzimi i grave me maskën e barazisë.....	87
Shtylla e fesë Namazi	103
Fitneja e historicizmit në manipulimin e fesë.....	115
Cilësitë e edukuesit	129
Gjallërimi i kohës para agimit me adhurime	141



Nderi dhe turpi	147
Vatra e qetë familjare	153
5 kushtet e martesës të suksesshme:	158
Rregullat e marrëdhënieve me jomyslimanët	161



